

INTERVISTË ME CRISTINA MARÍ

Prishtinë | Data: 31 korrik, 2017

Kohëzgjatja: 115 minuta

Të pranishëm:

1. Cristina Marí (E intervistuar)
2. Mia Crocetti Marzotto (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

Transcription notation symbols of non-verbal communication:

() – emotional communication

{ } – the speaker explains something using gestures.

Other transcription conventions:

[] – addition to the text to facilitate comprehension

Footnotes are editorial additions to provide information on localities, names or expressions.

Pjesa e Parë

Cristina Marí: Quhem Cristina Marí. Jam lindur në Ibiza, kështu që vij nga Spanja dhe jam 27 vjeçe, gati të bëhem 28 vjeçe në shtator.

Mia Crocetti Marzotto: Pra je lindur në Ibiza, si ishte atje?

Cristina Marí: Epo (qeshë), duke qenë e lindur në një ishull, e kam kuptuar, teksa kam kaluar më shumë kohë jashtë ishullit, gjithmonë e quaj timin sikur të ishte i imi, por është i të gjithëve. Jo, po mendoj të formëson disi. Është një vend që është bërë shumë turistik dhe me shumë njerëz me vite. Gjithmonë ka qenë, që nga vitet e '60-ta, '70-ta, por tash çdo vit po bëhet edhe më shumë. Po shohim rritje të madhe në të, por në të njëjtën kohë mendoj se të formëson në atë mënyrë që ti të kuptosh natyrën dhe fuqinë e asaj se sa mirë është të kesh këtë afërsi me natyrën ashtu që ajo bëhet diçka të cilën ti e merr shumë si të mirëqenë. Dhe kur udhëton dhe futesh më shumë në stilin e jetës në qytet me orët e ngarkuara dhe makinat dhe jeton në mes të ndërtesave. Apo si jetoj unë këtu me një ndërtesë përballë meje (qeshë), mëson të vlerësosh më shumë kualitetin e jetës së këtyre vendeve më të qeta siç janë ishujt.

Ibiza është vend që është bërë jashtëzakonisht turistik. Ekzistojnë poashtu shumë paragjykime për të, ekziston një koncept për atë se si je bazuar në atë se prej nga je, nëse je nga atje. Por unë jama lindur në një, po mendoj, jam lindur atje dhe pastaj jam rritur në periferi me qejë, pula, pata, të gjitha llojet e kafshëve, deri në moshën 18 vjeçare dhe pastaj kam udhëtuar për në Madrid për të studiuar.

Kështu që, mendoj se kjo të formëson. Sa herë kthehem në shtëpi e kam një ndjenjë se edhe unë kam ndryshuar, gjithashtu ne natyrshëm rritemi dhe asimilohemi me vlera apo stile të tjera të jetesës siç isha duke thënë. Por duke qenë e lindur atje, mendoj, disi të bën, nuk e di, mëson t'i vlerësosh gjërat në një mënyrë shumë intensive. Kur shkoj atje dhe e shikoj qiellin, gjithmonë shoh yjet dhe kjo është një gjë e rëndësishme, e të cilën mund të mos e kuptojmë derisa të jemi shumë larg prej saj.

Sidoqoftë, është gjithashtu vend i vogël dhe kur kam jetuar atje, po mendoj, është një vend ku, pak si Prishtina, pak a shumë të gjithë njihen. Jo të gjithë, por për shembull nëse bën muzikë apo je gazetarë, do të kesh rastin të njohësh të gjithë gazetarët apo të gjithë muzicentët, pak a shumë jeni në atë rreth. Dhe mendoj se kjo është diçka që vetëm këto vende të vogla mund të të japin, gjë që është e mirë në njërin anë, por në anën tjetër është klaustrofobike nganjëherë (qeshë), nëse mund të them.

Mia Crocetti Marzotto: Pra, pra, ke shkuar deri në, deri në shkollë të mesme ke qenë në shkollë në Ibiza?

Cristina Marí: Aha.

Mia Crocetti Marzotto: Në rregull.

Cristina Marí: Po.

Mia Crocetti Marzotto: Dhe pastaj shkove në universitet në Madrid?

Cristina Marí: Po. Unë, kur isha në Ibiza, gjithmonë kam pasur një dëshirë për të udhëtuar por jo gjithmonë ka qenë e lehtë, po mendoj, ka qenë e lehtë por kur nuk ke një familje njerëzish që udhëtojnë apo nuk e di, këto, lehtësira, disi të udhëtuarit nuk bëhet shumë interesante deri kur e bën në fakt për herë të parë. Gjithmonë kam dashur të udhëtoj por kurrë nuk kam bërë diçka shumë përpos udhëtimeve të shkollës dhe gjëra të tilla. Dhe pastaj vendosa të shkoj në Madrid për të filluar studimet në gazetari dhe arsyeja pse vendosa të shkoj atje... gjithmonë e mendoj se një lloj vetie karakterizuese e imja është se, kam dashur të filloj nga zero në një vend të ri ku nuk njoh askënd dhe nuk më njeh askush. Ku mund, le të themi, të zbuloj vetveten, personalitetin tim në një mënyrë ku askush nuk mund të më gjykojë prej nga vij apo çfarë kam bërë më parë. Të gjithë shokët e mi të shkollës së mesme, dhe shumica e të rinjve në Ibiza gjithmonë vendosin të shkojnë në Barcelonë sepse është më afër, ka më shumë mundësi për të udhëtuar, më shumë lidhje brenda ditës. Shumë njerëz gjithashtu studiojnë atje në mënyrë që ta kenë më të lehtë të lidhen menjëherë me grupin atje.

Vendosa të shkoj në Madrid, kisha qenë atje për një kampionat të xhudos, ushtrija xhudo më parë (qeshë) dhe më ka pëlqyer me të vërtetë, ka pasur një shije të jetës së lagjes në të cilën jam ndier shumë rehat. U zhvendosa në vitin 2007 dhe qëndrova atje deri në vitin 2011. Katër vjet, sepse studimet e mia në gazetari ishin një gradë pesëvjeçare para se të gjitha programet të ndryshoheshin në programe më Bolonjeze të Hapësirave Evropiane të Edukimit. Dhe mendoj se pata marrë vendimin e duhur (qeshë).

Shpesh kam dashur të bëj gjëra të tjera ndërkohë që studioja atje. Doja të studioja shkencë politike, doja të studioja juridik, doja të studioja histori, doja të futesha në [studime] gjinore sepse gjithashtu... por në të njëjtën kohë, përgjatë studimeve të mia, kam pasur rastin të studioj nga pak prej të gjitha këtyre fushave të ndryshme. Gjithmonë jam munduar të marrë kurse plotësuese dhe të shkoj në konferenca, trajnime raportuese dhe...

Por megjihatë mendoj se ishte kohë shumë e mirë sepse kjo ishte koha kur e tërë lëvizja *Indignados* [Të Indinjuarit] ndodhi. Kjo është një lëvizje që u organizua në vitin 2011, në mars nëse nuk gabohem, në mars ose maj... maj, më fal. Dhe është një lëvizje që e ka riformësuar në tërësi mënyrën tonë të organizimit si shoqëi. Mendoj se ka lënë shumë gjurmë në atë si njerëzit oganzojnë rezistencë paralele, nëse mund të them kështu (qeshë).

Dhe unë isha pjesë e saj, u angazhova aq sa munda, të paktën për një muaj në fillimet e saj. Pastaj u decentralizua në protesta më të vogla, në grupe më të vogla punuese. Në atë kohë isha angazhuar me një grup njerëzish që provonin të merreshin me gazetarinë dhe si ajo mund të shërbente. Le të themi, interesi publik në një mënyrë etike, dhe me një përgjegjësi shoqërore. Kështu që për shumë ditë brenda atij viti në të cilat na duhej të studiojm për provime, ne vetëm mundoheshim të gjenim

mënyra dhe kohë për të shkuar në shesh dhe për të parë nëse mund t'iu bashkoheshim këtyre grupeve diskutuese që po vazhdonin për më shumë se një muaj.

Ishte përvojë me të vërtetë emocionuese, kam pasur rastin të përjetoj diçka të tillë që e ka formësuar mënyrën si e shoh gazetarinë e gjithashtu edhe rolin tim si qytetare, kam provuar ta marrë me veti atë përvojë kudo që kam shkuar vetë.

Mia Crocetti Marzotto: A ke qenë më parë e angazhuar në ndonjë qytetari aktive në Ibiza, apo ishte diçka që e ke mësuar apo nisur në Madrid?

Cristina Marí: Do ta kujtoj gjithmonë protestën e parë të madhe në të cilën kam marrë pjesë dhe jam shumë krenare që kam marrë pjesë. Ishte në Ibiza, isha diku 16 ose 15, 15-16, ishte dy vite para se të hyja në universitet. Kështu, shtëpia ime, shkolla ime e mesme ishte shumë afër një zone ku ndodhte gjithçka. Ishin dy rrugë të larta, i quanim autostradë, edhe pse nuk ishte saktësisht një autostradë, por qartazi kishte interes prapa ndërtimit të këyre rrugëve të cilat ishin krejtësisht të panevojshme për dimensionet e ishullit tonë... dhe ndërtimi i këtyre rrugëve do të thotë rrënim të shumë shtëpive, shumë fqinjë që kishin jetuar aty për një kohë të gjatë u desh të largoheshin nga shtëpitë e tyre.

Ishte një hapësirë shumë afër shkollës sime të mesme në të cilën, e cila konsiderohej kryeqendra e rezistencës kundër këtyre rrugëve. Dhe të gjitha partitë kishin gisht në ndërtimin e tyre. Kështu që nuk isha, ishte me të vërtetë një rezistencë qytetare, sidomos në fillim. Dhe më kujtohet që edhe nëna ime mernte pjesë në protestë ndonjëherë. Kishte kohë kur buldozherët vinin për të shkatërruar këto shtëpi, por banorët dhe fqinjët bëheshim bashkë dhe formonin një zinxhir njerëzish për të ndalar shkatërrimin e ndonjë shtëpie të caktuar nga buldozherët, apo për të ndaluar hyrjen e tyre në një fushë të caktuar, oborrin e shtëpisë apo diçka.

Gjithmonë mundohesha të ikja nga orët, unë dhe disa bashkëmoshatarë të mi. Më kujtohet një protestë e madhe e cila praktikisht u organizua nga, nga të gjithë nxënësit, të gjithë nxënësit nga të gjitha shkollat e mesme. Të gjithë u mbledhëm në një mënyrë shumë të improvizuar përpara organit kryesor qeverisës të ishullit, një lloj këshilli, dhe aty e filluam protestën. E zaptuam këshillin, dolëm aty dhe po e çmendnim policinë sepse ishim absolutisht të paorganizuar. Vetëm po e zaptuam rrugën dhe marshonim, zaptuam dhe bllokunim të gjithë rrethinën në qendër të qytetit (qeshë), na u deshën orë, dhe ndoshta kjo ishte hera e parë që ika nga mësimi, jo vetëm, ika nga mësimi dhe mora pjesë në një nismë të tillë që erdhi nga një rini që nuk dëshironte të lejonte një gjë të tillë të ndodhte.

Kjo ishte hera e parë kur pashë fuqinë e njerëzve. Unë, natyrisht rrugët u ndërtuan më vonë në rrethana shumë të errëta, buldozherët erdhën në pesë të mëngjesit dhe shkatërruan gjithçka. Por ishte mësim që e mora thellë në vete sepse aty shihje njerëz duke mbrojtur shtëpitë e tyre. Diçka kaq bazike si shtëpia jote, kulmi yt, vendi ku je rritur, ku janë kujtimet tua, gjithçka është aty dhe po shkatërrimi që i linte vend ndërtimit. Ishte poashtu diçka simbolike sepse shkatërrimi i asaj rezistence ishte si goditje ndaj lëvizjes disi, prekje e qytetarisë. Sidomos kur interesat nuk i sjellin përfitim shoqërisë në atë rast.

Pra, me gjasë kjo ishte hera e parë kur me të vërtetë pashë fuqinë e njerëzve dhe u angazhova dhe... më kujtohet që, natyrisht, nëna ime shpesh aty dhe kurrë nuk më lejonte të afrohesha shumë. Sepse kishte arrestime nga policia e gjëra të tilla. Kishte njerëz që lidheshin me zinxhirë nëpër pemë, e gjitha isht disi shumë dramatike, nëse e shikon nga distanca, është... për disa njerëz ishte shumë e dhimbshme si pamje dhe përjetim.

Mendoj se kur shoqëritë bashkohen dhe krijojnë një lëvizje këmbëngulëse e cila nuk ka sukses, e cila prapë se prapë mposhtet, mendoj se të gjithë dëmtohen ngapak si qytetarë, si njerëz dhe disi të gjithë e bartin atë me vete. Ndoshta si njeri e bartni atë dhe... nuk e di, meqë i kisha parë ata, kur shkova në Madrid dhe pashë këtë protestë duke ndodhur dhe të gjitha këto lëvizje rezistence që ndodhnin në mënyrë shumë të fuqishme nuk mund të... fillimisht isha kurioze, për herë të parë isha në këto mbledhi të cilat çuan në këto lëvizje në Fakultetin e Shkencave dhe Informacionit, i cili është, ishte fakulteti im.

Më kujtohet që kam parë disa posterë në rrugë... në muret e fakultetit dhe ata thjesht po mblidheshin për të diskutuar për programin e Bolonjës të Edukimit Hapësinor Evropian. Dhe nuk e dija fare çfarë ishte kjo gjë, sapo kisha filluar fakultetin dhe isha kurioze çfarë ishte kjo gjë për të cilën njerëzit po uleshin për të diskutuar dhe madje edhe për të protestuar. Më kujtohet të ketë qenë një grup tepër i vogël i njerëzve herën e parë kur kam shkuar. Mbase tre-katër studentë më të vjetër nga fakultete të ndryshme që kishin filluar të mblidheshin, nga filozofia, gazetaria, historia. Dhe fillova ngadalë të mësoj dhe u rrëmbeva krejtësisht nga mënyra si po ndodhnin gjërat sepse nuk ishte thjesht, “Ejani të bëjmë një protestë”. Në fakt ishte, “Ejani të ulemi të lexojmë për këtë program, ta kuptojmë si funksionon kështu që të mund të krijojmë argumente kundër tij”.

Kjo nuk ishte thjesht protestë, ishte një këmbëngulje e mençur, ishte gjithashtu krijim i shumë rrjeteve, uleshim në fakultet për disa orë. Më kujtohet që patëm marrë leje për të qëndruar gjithë natën. Qëndruam në fakultet gjithë natën. Quhej, diçka si, epo në anglisht e quajmë *overnight*, mund të jetë e vështirë për t’u përkthyer por për disa netë qëndruam në fakultet gjatë natës, e njëjta ndodhte poashtu edhe në fakultete si ai i historisë ose filozofisë. Por pastaj ideja ishte që të shfrytëzojmë këtë kohë sepse përgjatë ditës na duhej të mësonim dhe ideja ishte të mos humbisnim orët apo kohën e studimeve dhe të mos dilnim keq në provime. Por na duhej ta shfrytëzonim kohën bashkë për të menduar për veprimet që duhej të ndërmerim, si mund t’i luftonim ligjërisht, a do të mund të shkonim në televizion për të pasur një diskutim rreth tyre dhe për të provuar t’i shtyjmë këto çështje në një shkallë më të lartë. Dhe pastaj natyrisht vinin protestat dhe marshet por gjithashtu mundoheshim të krijonim rrjete dhe hapësira diskutimi kështu që këto çështje të mund të diskutoheshin aq sa ishte e nevojshme dhe ku mund të rregulloheshin nëse mund të rregulloheshin, apo si do të mund të kontribuonim ne si studentë dhe aktivistë në këtë çështje.

Pra isha pjesë e kësaj për disa kohë, dhe kjo gjë ka ndikuar në mënyrën si unë e shoh se si ne qytetarët mund të bëhemi aktivë dhe të ndryshojmë gjëra. Dhe pastaj lëvizja kaloi nga, ne si studentë po luftonim, le të themi këto programe, por njerëz të tjerë luftonim për shëndetin publik, të tjerë për edukimin publik në shkolla dhe të gjitha këto lëvizje eventualisht... Më kujtohet që ishte shumë e rëndësishme edhe një lëvizje për të drejtën në banim dhe të gjitha këto eventualisht u bashkuan dhe e tërë lëvizja *Indignados* ndodhi, le të themi si rezultat i natyrshëm i të gjitha këtyre lëvizjeve paralele që po ndodhnin në të njëjtën kohë në fusha të ndryshme dhe të gjithë njerëzit u bashkuan dhe ishte një mënyrë shumë publike e të diskutuarit të çështjeve publike. Kishte njerëz për më shumë se një muaj në një shesh publik, jo vetëm në Madrid por në të gjitha qytetet e vendit, në shumicën e qyteteve të vendit. Mijëra diskutime në lidhje me atë se si mund të përmirësojmë sistemin shëndetësor, si mund të luftojmë për politika më të mira ambientaliste, si mund të luftojmë për media më të mirë, për media

më të përgjegjshme që i shërben interesit publik, si mund të ndryshojmë kushtetutën nëse është e nevojshme, në çfarë mënyre mund ta bëjmë.

Kështu që u desh shumë punë dhe ishte një lëvizje tjetër për feminizmin dhe të drejtat e grave. Por gjithashtu kishte një lëvizje ku burrat u mbledhën për të parë se si roli i tyre në shoqëri mund të luhej ndryshe dhe të përmirësonte barazinë për të gjithë. Dhe kështu e gjithë lëvizja, e kam parë, kam qenë pjesë e saj dhe ka ndryshuar apo formësuar qasjen time ndaj gjithçkaje që bëj sot. Mendoj se ajo më ka bërë mua, në një mënyrë jam munduar ta aplikoj në punën time qoftë kur kam qenë në gazetari apo duke punuar në ndonjë organizatë duke organizuar forume diskutimi apo veprime advokimi dhe gjëra të tilla.

Mia Crocetti Marzotto: Pra, e përmendët nënën tuaj, a bënit biseda të tilla edhe në shtëpi, apo si ishte në familjen tuaj? Po mendoj, atëherë kur ishe në Ibiza, në Madrid?

Cristina Marí: Mendoj kur kam qenë e re dhe këto protesta po ndodhnin, ishte një... në përgjithësi, jam motivuar shumë duke parë nënën time të protestonte. Ajo gjithmonë ka qenë relativisht e angazhuar në çështje shoqërore kur vjen tek dalja në protesta është diçka që po bëhet paksa, mbase është diçka natyrale të arrish në një pikë ku ke më pak shpresë dhe e sheh se nganjëherë një protestë nuk mjafton dhe mbase njerëzit ndalojnë së daluri. Por të gjitha këto gjëra po ndodhnin, në njërin anë është qesharake, nëna ime është gjithmonë ajo që është më shumë e angazhuar në shoqëri ndoshta. Prindërit e mi e kuptojnë këtë në një mënyrë pak më ndryshe. Babai im është më pesimist dhe mendon se asgjë nga këto nuk do të ndryshojë asgjë. Ai është njeri me vlera shumë serioze por kur vjen puna tek protestat apo politika e gjëra të tilla, nuk ka shpresë për të se dikush mund t'i adresojë këto çështje që duhet adresuar, nëse mund të them.

Por shpesh politika është bërë një temë për të cilën nuk diskutoj më, mundohem të mos diskutoj të paktën. Kemi grindje gjithë kohës, supozoj se mund të them që në secilën familje ka grindje për politikë, edhe në timen. Motra ime më sheh gjithmonë si idealistja që mendon të ndryshojë botën. Ajo gjithmonë më thërret ombuds person (avokati i popullit). Por mendoj që është e natyrshme që secili anëtar i familjes të luajë një rol të ndryshëm. Mendoj se e krijojmë njëfarë balanci me njëri-tjetrin. Mendoj gjithashtu që ka qenë shumë mirë të shihja nënën time në protesta për shembull kur kishte policë që arrestonin njerëz, e dini, më jpte një lloj ndjenje që është në rregull të shpalosesh dhe të rezistosh sepse nganjëherë do të duhet të bësh diçka të tillë pasi që nuk do të thotë që shteti gjithmonë do të jetë i mirë me ty apo diçka e tillë. Por ishte një rol model për mua në atë kuptim ta shoh atë duke qenë pjesë e këtyre protestave dhe gjithmonë kam... nuk më ka ndaluar, natyrisht nganjëherë babai më ka thënë, "Oh, ke shumë..." ekziston një shprehje në spanjisht që, "Ke shumë zogj në kokën tënde," nuk jam e sigurt nëse ky do të ishte përkthimi në anglisht...

Mia Crocetti Marzotto: Çfarë, si është në spanjisht?

Cristina Marí: "*Tienes pájaros en la cabeza*" do të thotë që je përplot me ide dhe idealizëm dhe mund të krahasohet me shprehjen sikur të ndërtohet kështjella në ajër në anglisht, besoj se po. Kështu që e di realisht. Mendoj disi thellë në vete se ata e mbështesin këtë idealizëm dhe këtë luftë të përhershme për aq gjatë sa bëhet për parime të vërteta. Mendoj se kjo është ajo që, ajo që ata do të donin ta shihet të ndodhë, e dini, të paktën është një qasje konstruktive ndaj gjërave dhe jo mënyrë irracionale e

sjelljes. Mendoj se prindërit gjithmonë duan që ti të jesh i arsyeshëm dhe mendoj që kjo gjë është e sigurtë.

Mia Crocetti Marzotto: Dhe, a mund të pyes, çfarë bëjnë prindërit e tu?

Cristina Marí: Po...

Mia Crocetti Marzotto:... Çfarë punojnë?

Cristina Marí: Po, po. Babai im është hidraulik. Ka punuar gjithë jetën e tij, shumicën e jetës së tij si hidraulik. Nëna ime punon në mirëmbajtje të shtëpisë dhe motra ime, ajo është më e vjetër se unë, pesë vjet më e vjetër se unë dhe punon në turizëm me hotele, rezervime. E ndryshon herë pas here nga pak, por të gjithë janë disi ngapak të lidhur me industrinë e turizmit, por është mirë, është...

Mia Crocetti Marzotto: Dhe ata ende jetojnë në Ibiza apo?

Cristina Marí: Po. Ata ende jetojnë në Ibiza dhe gjithmonë do të jetojnë atje dhe ai gjithmonë do të jetë vendi ku unë do të kthehem, gjithmonë. Kemi një shtëpi atje, shtëpia jonë është atje. Nëna ime ka shkuar në Ibiza nga Granada kur ka qenë 14 vjeç, nga jugu i Spanjës, dhe në atë kohë ajo kishte dy teze që punonin në atë kohë në një hotel si kamarierë dhe pastruese dhe babai im.... Babai i saj kishte punuar poashtu aty por gjithmonë ka qenë interesant të mësoj për përpjekjen e saj jetësore si grua, mendoj se sidomos si grua ke shumë sfida në përgjithësi.

Kur e ka përfundua shkollën, në vitet e '70-ta, besoj se është lindur në vitin 1960, diku në përfundimin e diktaturës së Frankos, kështu që mendoj se ajo ka ardhur në Ibiza para kësaj. Dhe ndoshta, mendoj se nuk dëshironte të vazhdonte studimet. Nuk ishte puna tek paratë apo familja, po mendoj, ata ishin familje modeste dhe dëshironin të vazhdonin, ata i kishin thënë, "Nëse do të shkosh në shkollë, në rregull, nuk ke nevojë të punosh," por nëna ime ka vendosur të mos shkonte në shkollë dhe njëherë e kam pyetur, "Pse?" Dhe ajo më tha, "Nuk më ka pëlqyer". E dini. Mendoj se shkolla si ka qenë atëherë dhe si është tani është shumë ndryshe. Dhe mendoj se ai ishte një vend shumë strikt ku dënoheshe nëse mbaje një libër me dy duar, në gjunjë për një kohë, ishte një vend ku goditesh me vizore dhe gjëra të tilla, dhe mendoj se diçka e tillë nuk është tërheqëse për një fëmijë që të vazhdojë shkollën. Dhe ajo ka vendosur të vijë në ishull ku familjarët e saj punonin në atë kohë. Gjithmonë dëgjoj tregime fantastike dhe shumë të qeshura prej saj kur flet për kohën kur ka punuar në këto hotele dhe pastaj më ka lindur mua dhe motrën time kështu që është ndalur nga puna dhe është kujdesur për ne e shumë gjëra të tjera. Jo shumë gjëra të tjera, por është ndalur nga puna dhe ka qenë në shtëpi me neve. Kështu që, mendoj se kjo gjë e ka ndryshuar gjithmonë mënyrën se si e shoh unë nënën time sepse si grua ajo ka pasur sfidat e veta dhe është inspiruese të shohësh gratë në botë teksa arrijnë në jetë në përgjithësi.

Mia Crocetti Marzotto: Përmendët natyrën dhe kafshët. A do të mundeshe të ndash me ne ndonjë kujtim shumë të dashur nga fëmijëria?

Cristina Marí: Epo ndoshta, më kujtohet sidomos tani që jemi në verë, me dashuri i kujtoj ditët e verës atje. Kurrë nuk kemi qenë një familje që shkon në plazh edhe pse kemi jetuar afër, tepër afër plazhit

por verat për ne gjithmonë lidheshin duke bërë punë dore gjithë kohës. Motra ime ka qenë shumë kreative dhe së bashku shkoni në plazh për të mbledhur gurë të cilët i ngjyrosim dhe bënim të gjitha llojet e artit, dhe kjo është diçka që e mbaj ende. Tash kur mërzitem ndonjëherë, bëj diçka me baltë ose, kjo ka qenë mënyra si e kam kaluar kohën, jo gjithmonë *Netflix* apo duke shikuar seriale, edhe pse e bëj edhe atë gjë, natyrisht.

Por mendoj, vera atje është pak më ndryshe. Vera atje nënkupton shumë kohë jashtë e jo brenda shtëpisë, ne kalonim kohë duke luajtur jashtë, e dini, duke zënë njëri-tjetrin, duke vrapuar pas njëri-tjetrit dhe me kushërinjtë tanë të cilët vinin nganjëherë për të kaluar verën në Ibiza nga Granada. Edhe unë shkoja atje, fëmijëria ime ishte kryesisht në zona rurale, po mendoj, i ndihmoja nënës në mbjelljen e patateve apo gjëra të tilla, më ka pëlqyer të bëj gjëra të tilla dhe mendoj se kjo është diçka që më mungon tash që po plakem. Më mungon të qenit pjesë, ta kem atë afër çdo ditë dhe disi refuzoj ta përqafoj jetën e qytetit dhe ende rezistoj, kam dëshirë që në të ardhmen, nuk e di, thjesht do të jetoj në periferi, qoftë këtu apo kudo tjetër, do të kthehem pak tek ajo sepse edhe nëse nuk jetoj në Ibiza apo diçka, unë ende kur kthehem është sikur, jam atje për dy javë dhe nuk është se e kaloj gjithë kohën në periferi duke ndihmuar prindërit e mi me të mbjellurat e me pemët e duke shikuar gjëra, por është diçka që do të doja ta bëja një ditë, të kthehem dhe disi kjo gjë të bën të jesh më afër rrënjëve tua në njëfarë mënyre.

Nuk e di, është diçka që e kam dashur kur kam qenë fëmijë, gjithmonë kam qenë e rrethuar nga kafshët dhe ende është ashtu, kur shkoj në shtëpi, ne kemi tetë ose nëntë qenë, kemi një kalë tani, një papagall që flet dhe flet të gjitha llojet e fjalëve, i thotë emrat e të gjithë anëtarëve të familjes, emrat e qenëve, emrat e fqinjve, kështu që është bukur. Kurrë nuk mërzitemi nëse nuk duam të mërzitemi. Një gjë që më pëlqen është vera sepse kemi kaluar shumë kohë jashtë. Babai im i vendoste zmadhuesit e zërit jashtë dhe thjesht lëshonte muzikë. Hite të zakonshme verore lëshoheshin me rend, dhe kjo gjë nuk ishte në vijë me këtë qetësi rurale por ishte me të vërtetë qejf dhe pastaj unë luaja me qentë edhe nëse isha tërësisht vetëm.

Kam kaluar shumë kohë me shoqërinë time në shtëpitë e tyre apo timen, thjesht orë të tëra duke luajtur jashtë dhe as nuk e ndizim televizionin për asgjë. Po mendoj, kënaqeshim në atë mënyrë, edhe kur jam rritur, unë gjithashtu kam bërë shumë gjëra, shkoja në shkollë dhe nëna dhe babai im, ata nuk kishin asnjë problem që unë shkoja në të gjitha klasët e mundshme. Nuk është se ata dëshironin, ata nuk ishin lloji i prindërve që të lënë në shkollë në orën nëntë dhe të marrin në orën nëntë pasi që ke kaluar gjithë ditën nga njëra klasë në tjetrën por unë gjithmonë kam kërkuar të regjistrohem në atletikë. Është një gjë, në moshën pesë vjeçare e kupton nëse dua të shkoj menjëherë pas klasës apo dua të bëj basketboll, hendboll apo më vonë fillova xhudo dhe fillova të marrë edhe kurse muzike, kështu që gjithmonë kam qenë tepër aktive dhe më mungon ky hiperaktivitet që e kam pasur si fëmijë.

Tash e kuptoj ndryshe, më duket shumë e vështirë të dedikohem në gjëra të ndryshme kështu që kam zgjedhur një, dhe jam dedikuar aq sa kam mundur dhe eventualisht ndoshta do të rimësoj si të bëhem shumëdimensionale, në atë kuptim jam duke bërë njëqind gjëra.

Pjesa e Dytë

Mia Crocetti Marzotto: Përmendët xhodon. Si u përfshitë në xhudo në Ibiza?

Cristina Marí: Kam filluar të merrem me xhudo kur kam qenë, mendoj, rreth tetë vjeç. Nuk jam e sigurtë por mendoj se kam qenë tetë vjeç. Dhe gjithmonë kam qenë shumë e fuqishme fizikisht, nëse mund të them kështu (qeshë)... nuk jam frikësuar, por as nuk jam përfshirë në grindje me djemtë apo e dini... kam pasur disa djem në klasë që kanë bërë xhudo. Kështu që nganjëherë... si fëmijët, bëhen hiperaktivë. Dhe pata përfunduar duke diskutuar me ta dhe më kanë treguar se kanë qenë duke u marrë me xhudo, më kujtohet. Dhe thashë, “Hmmm, kjo duket si diçka që do të më pëlqente”.

Kështu që i tregova nënës se doja ta provoja. Fillova dhe jam marrë me xhudo për dhjetë vjet, deri në moshën 18 vjeçare. Dhe pastaj kam vazhduar pak, por... kur u zhvendosa në Madrid ndalova së marruri me... po mendoj, gjithçka që kisha bërë në Ibiza u ndërpre, e bëja vetëm kur kthehesha në shtëpi për pushime apo diçka. Por provoj të qëndroj e angazhuar me gjithçka, por natyrisht me kohë e kam ndërprerë. Por kam bërë xhudo për dhjetë vjet dhe gjithmonë më ka bërë të ndihem shumë e sigurtë dhe me vetbesim.

Kam rripin e zi në xhudo, kështu që... gjithashtu, kur kam qenë në Madrid kam marrë disa trajnime për vetë-mbrojtje. Të cilat ishin të destinuara të aplikohen në rrugë, jo vetëm, sepse xhudo është sport, e dini... nuk është njësoj kur je në një ambient ku e di çfarë je duke bërë dhe rivali yt e di çfarë je duke bërë dhe përplaseni. Por gjithashtu jam ndjerë sikur ajo ka qenë diçka që më ka bërë shumë vetëbesuese dhe eventualisht më ka përgatitur për çfarëdo situatë të papritur në rrugë. Nuk e di, gjithmonë mendoj nëse diçka do të ndodhte, nuk e di a do të isha e aftë të reagoj. Sepse truri të mashtron në mënyra të ndryshme. Por më ka bërë të ndihem shumë mirë, dhe kjo ishte gjithashtu, sporti ishte diçka që më ka mësuar shumë për, hmm... veten dhe kontributin që duhet dhënë nëse në të vërtetë do të arrish diçka.

Kam pasur fatin të kem një trajner shumë të mirë i cili quhet Teo, Teo Balsquez. Dhe ai ende vazhdon të jetë trajneri i klubit tonë në vendlindjen time. Kështu që kemi mësuar shumë, më shumë se thjesht teknika. Ka qenë si proces i zbulimit të vetvetes, kapaciteteve, frikave.... Çfarë je i aftë të bësh? Apo nganjëherë, më ka ndodhur që isha në peshë, xhudo funksionon me peshë, kështu që për një kohë isha në një peshë që nuk mund të kisha rival. Kështu që shkoja nëpër gara dhe nuk kisha askë për t'u përballur për shkak të peshës sime. Isha peshë e lehtë kështu që gjithmonë ishte paksa e vështirë për të pasur dikë në anën tjetër.

Pra kjo ishte tepër bezdisëse sepse unë fitoja kampionatin pa u përballur fare. Isha vetëm, isha e vetme në kategorinë time. Kjo më ka mësuar se vetëm pse ke medalje, nuk do të thotë që je më i miri (qeshë). Më i miri nënkupton shumë gjëra të tjera. Kështu që ishte pak, u bë një garë e imja me vetën rreth asaj se ku doja të arrija, kjo është shenja ime e humbjes ose fitores. Pra, kështu.

Do të doja të kisha më shumë garë. E kam dashur dhe e dua ende kur ka më shumë njerëz që e bëjnë të njëjtën gjë si unë. Njerëz nga të cilët mund të mësoj dhe njerëz me të cilët mund të punoj. Mendoj se është më e shëndetshme sesa të qenit krejtësisht vetëm, të monopolizosh gjithë kategorinë për vete (qeshë).

Mia Crocetti Marzotto: Kjo është shumë interesante. Pra, kur je shpërngulur nga Ibiza në Madrid, si je ndier, si je ndier në ndërveprim me njerëzit e tjerë? Duke qenë dikush që vjen nga një ishull, duke qenë e vetmja që vjen nga ishulli, ndonjë kujtim të veçantë?

Cristina Mari: (buzëqeshë) Po, më kujtohet, unë... kur kam shkuar në Madrid, kam zgjedhur një konvikt të studentëve, mund ta... ekziston një traditë e konvikteve të studentëve në Madrid. Dhe ka disa lloje të komuniteteve, komunitete të mëdha. Dhe unë e pata zgjedhur një konvikt që ka pasur shumë histori. Ka pasur historinë e të qenit vend i rezistencës në të kaluarën dhe në të '60-tat, sidomos rezistencës kulturore. Dhe kishte një klub të xhazit dhe muzikës, kështu që ndihesha sikur do të kisha nderin të isha në atë vend. Por në fakt ishte me të vërtetë tepër me këmbë në tokë.

Dhe pastaj kishim, natyrisht në vitin e parë ka... Si studentë të ri, ka shaka nga veteranët që kanë jetuar aty për kohë të gjatë. E kam urryer atë pjesë (qeshë), nuk kam, nuk ka qenë aq keq. Ishte në rregull, disi kjo gjë na ka bashkuar. Kjo është më shumë brenda të kuptuarit se, "Jo, nuk na pëlqen kjo pjesë". Por, kishte gjithashtu disa, më kujtohet në atë kohë, mendoj se ishte i njëjti vit... ishin dy djem nga Ibiza poashtu, ata vinin nga një pjesë krejt në veri, ndërkohë që unë vij nga një pjesë krejt në jug. Kështu që, nuk kisha aspak lidhje me ta. Dhe kjo ishte shumë interesante për mua. Sepse mësohesh të tregosh nga vjen... dhe pret të njohësh çdokënd, por në fakt nuk ka ndodhur kështu kur kam shkuar në Madrid.

Kjo ishte njëra prej gjërave, besoj, që më bëri të kuptoj se vendi, bota është më e madhe se që mendon. Dhe ishulli nga vjen nuk është edhe aq i vogël. Por pastaj, ishte gjithashtu mirë sepse nuk e njihja askënd, fare. Dhe kjo ishte diçka shumë e mirë. Ndihesha mirë sepse më dukej sikur gjithçka që ndodhë nga tani, më takon mua. Unë gjykoj, njerëzit nuk do të më gjykojnë sa të munden për veprimet e mia, as bazuar në atë se nga vij, as bazuar në asgjë. Kështu që, kjo ishte gjë shumë e mirë, dhe kam takuar njerëz që më kanë hapur shumë mendjen.

Ka shkuar shumë shpejt. Në vitin e parë ne ishim një grup... po mendoj, zakonisht krijonim shoqëri me njerëzit në korridorin tonë. Por pastaj përfundoje aty ku kishte shumë grupe pune gjithashtu. Kishe mundësi të angazhohesh në klubin e radios, sporte, apo në grupin e të drejtave të njeriut për të bërë aktivitete. Pra, kishte klube të vogla të universitetit në secilin konvikt. Ishim 400 njerëz që jetonim aty. Kështu që ishte shumë... një komunitet i këndshëm disi. Kështu që, sa isha aty kam ndërmarrë shumë nisma mbi... dhe isha e lumtur kur shihja plot koncerte të veçanta. Sepse siç thashë, ky vend kishte histori të madhe të ngjarjeve kulturore që ndodhnin aty.

Kështu që ne si student, shkonim në pizhama të shihnim koncertin e këngëtarit më të mirë të flamengos në vendin tonë, apo gjëra të tilla, apo një botë të re xhazi që po niste apo diçka e tillë. Dhe bukvalisht shkonim në pizhama për të shikuar gjithçka falas. Kështu që, isha shumë e privilegjuar që isha aty ku isha. Më kujtohet edhe pse ishte dhe tingllon shumë *cool*, divanët ishin të djegur nga njerëzit që kishin pirë cigare dhe i kishin shkatërruar tërësisht (qeshë). Nuk ishte me të vërtetë aq qejf, dhomat sidomos ishin të vogla. Sepse ideja e arkitektëve kur kishin ndërtuar atë vend ishte se njerëzit, studentët do të kalonin shumicën e kohës së tyre në hapësirat e përbashkëta, kështu që dhomat ishin tepër të vogla. Kishte vend vetëm për një shtrat dhe një lavaman, një dollap të vogël dhe një tavolinë. Dhe ishte bukvalisht një shtrat i vogël, dollapi {shpjegon me duar} përpara, lavamani, dhe kaq.

Por në anën tjetër, hapësirat e përbashkëta ishin shumë të mëdha dhe goxha të frenkuentuara. Në mes të secilit korridor, kishte një hapësirë dhe shpesh nuk njihje njerëzit, por disi dalëngadalë kur

shkon në banjo dhe gjen të njëjtin grup njerëzish të ulur aty çdo natë, përfundon duke iu bashkuar dhe duke kaluar kohë me ta sepse... besoj se kjo është gjithashtu diçka që ka të bëjë shumë me...

Mia Crocetti Marzotto: Pra ti ke jetuar në konvikt përgjatë gjithë kohës sa ke qenë në studime...

Cristina Marí: Dy vjet...

Mia Crocetti Marzotto: Dy vjet...

Cristina Marí: Kam qëndruar aty për dy vjet pastaj jam zhvendosur në një banesë. Ndërtesa ishte afër konviktit të studentëve dhe për shkak të historisë, historisë kulturore që ajo kishte, edhe aty u organizua një lëvizje (qeshë) për të ndaluar mbylljen e saj, në të cilën morra pjesë edhe unë. Një bankë dëshironte ta merrte në pronësi dhe ta renovonte atë, por ekzistonte një frikë e madhe se ata kurrë nuk do ta hapnin përsëri për shkak se një renovim i gjithë ndërtesës do të kërkonte shumë para dhe investim, dhe ekzistonte një frikë se banka nuk do të investonte në diçka të tillë. Kështu që, u angazhova edhe aty. Dhe eventualisht u tërhoqa dhe u zhvendosa në një banesë me dy shokë, Javid dhe Raquel, dhe aty jetuam për një vit. Vitin tjetër, unë fillova të jetoj me një shok timin, një koreograf vallëzimi. Cimerja tjetër ishte muziciante që studionte telekomunikacion, kështu që kishte shumë muzikë në atë banesë. Edhe unë bëj ngapak muzikë, kështu që ishte mirë të jetosh aty.

Jetoja në qendër të qytetit, kështu që ishte pak më ndryshe. Ndihesha më e rritur, mbase, më e rritur disi (qeshë), kur jeton vetëm me dy njerëz... ishte mirë, shumë mirë. Dhe pastaj, eventualisht e kreu vitin e fundit në Rumani përmes një shkëmbimi. Isha në Bukuresht përmes një burse të Erasmus-it. Dhe pastaj kam punuar, kam punuar, kam studiuar aty vitin e fundit të studimeve të mia, kështu që kjo ishte njëfarë përmbyllje e gjithë viteve të universitetit, derisa erdha këtu.

Mia Crocetti Marzotto: Pse zgjedhe Bukureshtin në vitin e fundit?

Cristina Marí: Hmm {pi ujë} në Spanjë, si në të gjitha shtetet e tjera në Evropë, kemi bursat e Erasmus-it dhe ato ofrojnë vetëm disa mundësi. Po mendoj, disa, ka goxha shumë në Evropë, unë kisha qasje vetëm në ato që ishin në gjuhën angleze sepse unë nuk flisja as frengjisht as gjermanisht, kështu që anglishtja ishte e vetmja gjuhë me të cilën mund të punoja. Pastaj kishte një mundësi për të shkuar në Evropën veriore ku kishte mundësi të shkoje në shkollë në anglisht poashtu. Mendoj se ishte... nuk jam e sigurt nëse ishte në Norvegji, Suedi, mund të shkoje edhe në Danimarkë. Dhe gjithashtu mund të zgjedhje Mbretërinë e Bashkuar dhe pastaj edhe... pika më e largët ku mund të shkoje ishte Rumania dhe Bullgaria.

Njëra mundësi ishte Universiteti i Bukureshtit dhe tjetri ishte Universiteti Amerikan në Blagojevgrad, në të cilin kanë shkuar shumë njerëz nga Prishtina në fakt, kjo është qesharake, sepse doja të shkoja, ishte mundësia ime e dytë. Mundësia e parë ishte Rumania, me të vërtetë doja... pas katër viteve në Madrid, përsëri doja të shkoja në një vend të ri, disi të filloja prapë nga zero. Dhe e mora si një vit pushim, në të cilin në fakt do të provoja të futesha më thellë në gazetari, dhe duke qenë se ishte viti i fundit dhe gjithashtu disi si një urë drejt, mbase, punës si gazetarë ose... nuk isha e sigurtë ku do të më sillte. Isha e sigurtë që doja të shkoja në një vend tepër ndryshe ku realisht do të mund të mësoja shumë.

Gjithçka dija rreth Rumanisë në atë kohë ishin disa njerëz nga atje. Njëri nga shokët e babait tim, poashtu hidraulik, punon në ndërtim me të. E njohim atë sepse çdo vit vjen në Spanjë nga Rumania për të punuar. Dhe ai ka jetuar në Ibiza me gruan e tij për disa vjet, gjithçka që dija ishte kryesisht nga

njerëzit që i kisha rreth vetes, dhe ishte se atje kishte shumë migrim, e cila ishte një temë në të cilën isha e interesuar si gazetare. Kështu që mendova se ai ishte një vend ku do të mund të mësoja shumë.

Shkova në Bukuresht, mora bursën për të qëndruar atje për nëntë muaj, kështu që ishte viti i fundit. Dhe sapo arrita aty, kishte një lëvizje të tërë protestash që po ndodhnin përsëri (qeshë). Në të cilën, natyrisht, u përfshiva edhe unë paksa. Dhe aty përmes kësaj proteste takova shumë njerëz të mirë, dhe ishte një kohë ku ata dëshironin të privatizonin shërbimet e ambulancave. Dhe çdo gjë u bashkua {shpjegon me duar}, kjo ishte qershia mbi tortën e shumë politikave të tjera që nuk funksiononin mirë, dhe protesta vazhdonte çdo ditë në sheshin e Universitetit të Bukureshtit. Njëherë filluan në një qytet tjetër por pastaj në Bukuresht lëvizja vetëm u bë më e madhe e më e madhe.

Ata ishin inspiruar nga protestat *Occupy Wall Street* në Shtetet e Bashkuara, protestat *Indignados* në Spanjë. Dhe më kujtohet se kur thosha se jam prej Spanjës dhe kisha qenë pjesë e protestave *Indignados*, ishin shumë të interesuar të dijnë si kishte ndodhur dhe unë thjesht iu shpjegoja se nuk është se kisha bërë diçka por ajo... ata e kishin një qasje që uleshin të mendonin çfarë mund të bënim për t'i ndryshuar gjërat, përveç protestës, kjo gjë ishte shumë e mirë për mua. Pata rastin të takoj shumë njerëz në rezistencë, artistë me mendime shumë përparimtare, ndoshta aty kam takuar njerëz që ishin më shumë të orientuar nga arti. Dhe kam mësuar më shumë për mënyrën si hapësirat artistike ndryshonin mënyrën si ne i qasemi kooperativës, dhe kjo ishte diçka interesante që kam parë atje. Dhe pastaj unë, atje kam bërë udhëtimin tim të parë. Kam bërë një udhëtim.

Kisha shumë dëshirë të bëja një udhëtim *backpacking* [aventurier] për vete. Dhe erdha në Ballkan sepse ishte afër, relativisht afër. Kështu që, realisht mund të vizitoja shtete me pak buxhet kështu që ishte mirë, kështu erdha në Kosovë për herë të parë.

Mia Crocetti Marzotto: Cilat shtete të tjera i ke vizituar përgjatë udhëtimit?

Cristina Mari: Kam shkuar në Beograd nga Bukureshti, pastaj fillimisht në Zagreb, poshtë në Bosnjë, Mal të Zi, Shqipëri. Kam kaluar përgjatë veriut të Shqipërisë ku kam takuar disa njerëz përgjatë rrugës, dhe iu kam bashkuar një çifti për disa ditë, më kujtohet që iu bashkova një çifti australian, po mendoj njëri nga ta ishte nga Australia e tjetri kanadez. Dhe meqenëse isha e interesuar të mësoja nga udhëtues të tjerë me përvojë, ideja ime ishte të bëhem udhëtuese për kohë të gjatë, por vetëm (qeshë). Kështu që, iu bashkova një kanadezi i cili kishte shumë përvojë në auto-stop. Me të vërtetë doja të mësoja si funksionon auto-stopi, jo vetëm të mësoja por ndihesha më e sigurtë të shkoja me dikë që kishte më shumë përvojë se sa unë e kështu me rradhë.

Dhe në Bajraam Curr e cila është një qytezë në kufi të Shqipërisë, menduam të qëndrojmë aty. Nuk dinim shumë për vendin, por ishte shumë i vogël dhe nuk kishte shumë gjëra për të parë as për të bërë, dhe nuk kishte vende për të fjetur, kështu ishim duke diskutuar në rrugë dhe më kujtohen një burrë dhe një grua që na u afruan, ata ishin thjesht kuriozë, dhe na pyetën, “Nga jeni? Çfarë po bëni këtu?” “Po udhëtojmë.” “OK, udhëtim të mbarë.” Gjithçka shkoi...

Më vonë vendosëm se duhej të largoheshim nga qyteza dhe të provojmë të shkojmë në Pejë, në qytetin e Pejës, dhe u nisëm me auto-stop. Një çift ndaluan makinën dhe na morrën e na dërguan në Pejë, dhe ne iu thamë, “Nuk e dijmë nëse do të gjejmë një vend për të qëndruar në mënyrë që nesër apo pasnesër të nisemi për në Prishtinë apo diçka”. Dhe qëndruam në qytet për pak kohë duke provuar të gjejmë akomodim, ishim gjithmonë pa udhërrëfyes apo diçka, pa libra apo këshilla paraprake. Dhe nuk gjetëm asgjë, hoteli ishte pakëz i shtrenjtë dhe prapë disi e shohim një burrë i cili

quhej Hasan dhe shoku i tij, ata na thanë, “Mund të qëndroni tek ne dhe nesër mund të shkoni në Prishtinë me tren apo me autobus nëse doni”.

Kështu që, ata na ftuan për të kaluar natën në shtëpinë e tij dhe nuk qëndruam vetëm një natë por dy netë e tri ditë, dhe kjo ishte një mënyrë shumë domethënëse për të njohur dikë në Kosovë për herë të parë. Ata ishin jashtëzakonisht mikpritës, natën e parë organizuan grill me të gjithë komshinjtë dhe ai vjen nga një fshat që quhet Lubeniç, shuëm afër qytetit, nuk është larg, vetëm disa kilometra jashtë Pejës. Dhe fshati kishte përjetuar një masakër përgjatë luftës, dhe nuk i pyetëm fare për arsye se unë gjithmonë isha shumë e preokupuar me çështjen e luftës dhe me mënyrën si duhej t’i qasesha. Nuk doja të isha bezdisëse, aspak. Jam gazetarë por në atë kohë isha udhëtuese dhe nuk doja ta imponoja veten në jetën e tyre dhe vetëm se isha e huaj nuk do të thoshte se ata duhej të flisnin haptazi me mua për periudhën më të dhimbshme të jetës së tyre. Kështu që, nuk pyeta, por erdhi natyrshëm që ata na shpjeguan vetë. Dhe na treguan disa libra ku disa gazetarë të huaj kishin dokumentuar masakrat dhe gjithçka, dhe ata na treguan shumë rreth historisë dhe përvojave të tyre dhe ishin shumë mikpritës, të sjellshëm dhe...

Atë natë kemi bërë grill, ditën tjetër kemi ngrënë pite dhe të gjitha llojet e, gjithashtu kemi ngrënë drekë dhe kemi shkuar në qytet për kafe në Hotel Dukagjini nëse nuk gabohem. Na kanë vozitur me makinë përreth gjithë qytetit. Ata kishin disa të afërm më të ri të cilët na tregonin rreth studimeve të tyre dhe përpjekjeve për të gjetur punë. Më kujtohet një vajzë e cila ishte pjesë e familjes, ajo kishte humbur babain gjatë luftës dhe kishte mbetur vetëm me nënën dhe motrat e saj. Bashkëshorti i saj ishte në Belgjikë, dhe ajo mezi po priste të largohej, të shkonte atje.

Pra ata me të vërtetë hapën shtëpinë dhe zemrat e tyre dhe na treguan rreth jetëve të tyre dhe shpejt, shumë shpejt u ndjemë sikur kishim marrë mjaftueshëm dhe u larguam, ata na vozitën deri në qytet. Kur erdha këtu ishte shumë mirë sepse më kujtohet dita e parë, më duket se ishte 3 maji e cila është Dita Ndërkombëtare e Lirisë së Shtypit dhe...Më fal?

Mia Crocetti Marzotto: Cili vit?

Cristina Marí: Kjo duhet të ketë qenë në vitin 2012, 2012. Më 3 maj kam arritur dhe një ngjarje për Ditën Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit po ndodhte. Kishte një koncert në sheshin “Nënë Tereza”, atmosfera ishte shumë e mirë. Më kujtohet se pata qëndruar aty, kam folur me disa gazetarë, disa njerëz edhe nga Serbia që kishin ardhur për të marrë pjesë në gjithë ngjarjen, në festival. Dhe atmosfera ishte me të vërtetë e mirë. Pastaj erdha për të punuar, pas disa muajsh erdha për të punuar, futem në zyrën time, zyrën time të re e cila ishte zyra e Kosova 2.0, dhe e shoh posterin e kësaj ngjarje, Dita Ndërkombëtare e Lirisë së Shtypit. Vetëm atëherë e kuptova se në fakt Kosova 2.0 e kishte organizuar ngjarjen në të cilën kisha qenë para disa muajsh.

Nuk kisha takuar askënd, nuk kisha kontratë me askënd por ishte disi, ishte qesharake të shohësh si është jeta disi, po. Kur erdha këtu për herë të parë, u befasova kur pashë një festim të tillë për nder të Ditës Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit. Me të vërtetë më pëlqeu, si gazetarë, sepse mendoj se është diçka që e kemi marrë si të mirëqenë edhe pse nuk e kemi gjithmonë. Dhe nuk e përceptojmë si tonën ashtu siç duhemi, me të vërtetë u ndjeva mirë që pashë diçka të tillë, që isha pjesë e saj këtu.

Pastaj ditët tjera kam shëtitur rrugët e Prishtinës, kam folur me njerëz. Më kujtohet që kam shkuar në Bibliotekën Kombëtare për ta parë ndërtesën nga brenda sepse ishte... më kujtohet që kam shkruajtur për ndërtesën dhe si jam ndier për të nga larg, “Ishte shumë klaustrofobike,” këtë gjë e kam... këto janë fjalët që kam shkruajtur në ditarin tim. Dhe pastaj jam futur brenda ku kam takuar

një burrë i cili filloi të fliste me mua, mendoj se ai thjesht më ka parë që jam një e huaj që shëtitej përreth si turiste dhe ishte kurioz dhe kështu filloi të më fliste dhe unë jam.... Ai fliste italisht sepse kishte jetuar në Zvicër për një kohë, në pjesën ku flasin italisht kështu që disi e kuptoj italishten, dhe e kuptoja edhe atëherë, e kështu bëmë një bisedë.

Kudo ku shkoja kishte një gatishmëri për të folur, takuar dhe ndihmuar. Më kujtohet një promovim libri. Ai punonte në Bibliotekën Kombëtare por mendoj se ishte ndihmës aty ose diçka e tillë dhe thjesht dëshironte të më dhuronte një dhuratë, diçka për të kujtuar përvojën time të parë aty. Dhe kjo gjë ishte shumë e mirë, po mendoj, gjëra të tilla ndodhnin gjithë kohës. Kështu që, më vonë u largova, u largova nga Prishtina. Ishte një kohë shumë e mirë, isha e supozuar të qëndroja këtu për një ditë dhe qëndrova tri. Më pëlqente atmosfera gjatë kohës sa isha këtu.

Dhe pas disa muajsh përfundova studimet. Shkova në Amsterdam Utrecht për një gjë verore dy javëshe. Ideja ime ishte të qëndoja atje dhe të gjeja diçka, ndonjë punë ose... nuk doja të vazhdoja direkt me master për arsye se nuk isha e sigurtë çfarë doja të bëja, nëse dua të studioj përsëri për dy vjet, dua të jem tepër e sigurtë çfarë po bëj e çfarë jo. Kështu që, më duhej pak kohë. Kur isha në Utrecht e kuptova se atje ishte shumë pastër (qeshë), nëse mund të them kështu. Nuk ishte shumë për pastërtinë, ishte më shumë për faktin që nuk dija çfarë do të mund t'i kontribuoja këtij vendi. Nuk isha e sigurtë si do të mund të punoja si gazetarë aty. Provova të gjej punë por të gjithë kërkonin gjuhën holandeze. Shumë shpejt e kuptova se nuk ishte vendi i duhur për mua, e dini, njerëzit dukeshin shumë rehat, natyrisht nuk është gjithmonë ashtu dhe jam e sigurtë se ka shumë çështje për të cilat njerëzit kujdesen, por thjesht ishte pak e vështirë dhe jo shumë interesante për një gazetarë të re.

Kështu që, më kujtohet sa isha në Utrecht, kërkova punë online si gazetarë. Me të vërtetë kisha një ide të qartë se doja të punoja jashtë. Jo vetëm se kishte krizë për punësim në Spanjë, sepse kishte shumë papunësi dhe ende ka, por më shumë për faktin që doja të shkoja në një vend shumë ndryshe, të mësoj sa më shumë që mundem prej tij dhe të vazhdoj të mësoj prej përvojave të reja.

Dhe më kujtohet që pashë një mundësi për praktikë në Kosova 2.0, portal. Kisha qenë këtu dhe kisha një ndjenjë të mirë. Aplikova, dërgova CV-në time, dhe ishte disa orë pas afatit por në mëngjes ata m'u përgjigjën dhe thanë se kishin pranuar aplikimin tim. Kjo ishte CV-ja e vetme që kisha dërguar përgjatë asaj periudhe kur isha e supozuar të kërkoja punë. Kur e pashë, po mendoj, sapo kisha filluar, por kur e pashë isha shumë e bindur se do ta prisja dhe të shihja çfarë do ndodhte. Bleva biletën për në Spanjë, vendosa se Holanda nuk ishte për mua dhe prisja për intervistën përmes Skype me atë që më vonë u bë shefja dhe kolegja ime. Dhe, dhe, dhe, tri javë më vonë isha në Prishtinë duke punuar fillimisht si praktikante. Pastaj më vonë si autore dhe më vonë ndihmoja me koordinimin e një projekti, ndërsa tani punoj si menaxhere e programit.

Mia Crocetti Marzotto: Pra përgjatë kohës tënde si gazetarë, ose, më fal, përgjatë kohës tënde në Universitet dhe gjithashtu në Rumani e Holandë, a publikoje ndonjë artikull?

Cristina Mari: Fillova të jem gazetarë {bën thonjëzat me gishta}, nëse mund të them kështu, duke qenë praktikante në një gazetë lokale në Ibiza. Çdo verë përgjatë tri viteve të para të studimeve, bëja praktikë aty dhe ajo ishte shkollë e vërtetë sepse isha praktikante por bëja punën e gazetarëve të tjerë. Ishte gazeta më e lexuar, ishte gazeta që të gjithë e blenin. Në Ibiza ka traditë të gjatë të leximit të gazetës lokale. Punova aty, kam pasur rastin të mbuloj lloje të ndryshme të çështjeve, kulturore, nganjëherë politike, shkoja në konferenca për shtyp, intervista, bëja tema të veçanta. Kështu që, bëra shkollë të, le të themi, gazetarisë lokale. Dhe ajo ishte me të vërtetë, për mua ishte një proces i vërtetë i të mësuarit sepse kështu ke mundësinë të kuptosh të gjitha sfidat dhe problemet që mund të hasësh.

Gjithashtu, bën storie nga më të ndryshmet kështu që nuk ishte gjithmonë lloji i gazetarisë me protokol apo këta thanë këtë, ata thanë atë, kishte shumë shanse për të bërë tema të veçanta dhe për të shikuar më thellë në çështje. Por sidoqoftë, ajo megjithatë është gazetë ditore dhe në të nuk ke hapësirë si një revistë apo diçka të tillë.

Pastaj, kur isha në Rumani kam shkruajtur disa gjëra për një portal në spanjisht i cili kishte shtetet evropiane për fokus. Dhe nuk kam pasur mundësi të botoj më shumë se aq derisa kam ardhur këtu dhe kam filluar të punoj për Kosova 2.0. Por për mua, përvoja në gazetën lokale *Diario de Ibiza* [Ditari i Ibizës] ka qenë më shumë, hej, e dini... Nganjëhërrë kur je duke punuar duke zëvendësuar gazetarët që janë në pushime, kjo gjë e pengon shumë verën në këto lloj gazetash. Por ishte një përvojë shumë e vlefshme ku kam pasur rastin të mësoj nga gazetarë të tjerë profesionistë të cilët ishin nga atje, nga redaktorët. Dhe ishte vështirë, po mendoj, nuk është se ishte shumë e ashpër, por ishte shumë direkt. Ke vetëm një ditë për të bërë lajmet, për të bërë gjithçka, gjashtëdhjetë, tetëdhjetë faqet e kësaj gazete në mënyrë që gjithçka të mund të shkojë për shtyp. Pra, ishte shumë intenzive dhe me të vërtetë më pëlqente, më pëlqen ky lloj i gazetarisë lokale.

Dhe pastaj kur arrita në Prishtinë dhe fillova të punoj për Kosova 2.0 e cila është një revistë dhe në atë kohë punoja, punova, për herë të parë kam punuar në edicionin "Seksi" të revistës. Pra, natyrisht kishim kohë të krijojmë storie, të hulumtojmë, të bëjmë intervista. Dhe kjo ishte një përvojë tjetër tepër e vlefshme sepse këtu ka një qasje tërësisht tjetër, duhet të përqafosh të gjitha lajmet rreth këtyre çështjeve, çfarë shkon përtej tyre, duhet të glesh perspektiva të reja. Dhe ky ishte një tjetër proces që më ka përmbushur në një qasje tjetër të gazetarisë. Ishte shumë mirë dhe natyrisht edicioni "Seksi" ishte përvojë interesante gjithashtu.

Mia Crocetti Marzotto: Pra, a mund të na tregosh pak rreth progresit në Kosova 2.0 sa i përket rolit tënd?

Cristina Marí: Po, do t'iu tregoj nga fillimi.

Mia Crocetti Marzotto: Edhe disa data nëse mundesh, në mënyrë që ne të, po...

Cristina Marí: Po, kam filluar të punoj. Më kujtohet saktësisht dita kur kam zbankuar këtu, ishte 12 shtatori i vitit 2012 dhe fillova të punoj si praktikante. Isha, kisha përfunduar studimet dhe gjithçka dhe më kujtohen ditët e para kur kam marrë detyrat e para për revistë. Ishte koha kur po punonim në edicionin "Seksi". Dhe ishte shumë interesante sepse unë gjithmonë kam qenë e interesuar në çështjet gjinore, në feminizëm, në gjithçka që lidhet me trupin dhe mendjen. E kështu, pata mundësinë të marrë pjesë në një projekt që hulumton seksualitetin dhe mënyrën si ai ndikon në jetërat tona si pjesë e shoqërisë. Ishte me të vërtetë inspiruese të jesh aty, dhe interesante por edhe sfiduese sepse unë kisha idetë e mia dhe gjithë të tjerët kishin idetë e veta kështu që disi i bashkuam.

Unë, unë, unë kam bërë një storie për transgjjinorët, në fakt ishte storie për një doktor në Beograd i cili është i famshëm në gjithë botën për operacionet e tij përmes të të cilave bën transformimin, më falni, nga, nga femër në mashkull. Pra, udhëtimi për atje ishte në mënyrë të veçantë interesant. Dhe gjithashtu kam punuar në një storie tjetër rreth individëve dhe asaj se si këta persona janë të ndikuar nga seksualiteti i tyre, dhe cilat janë idetë rreth tij këtu, në këtë kontekst.

Kam bërë edhe storie të tjera për revistë, të cilat ishin, natyrisht inkurajuese për mua si gazetarë, vetë fakti që kisha rastin të punoj në projekte të tilla ishte inkurajues. Çdo javë kishim takimet me redaktorin, të cilat ishin një koncept tërësisht i ri i takimeve me redaktor për mua, sepse kam ardhur nga një gazetë dhe kur vjen nga një gazetë ke takime me redaktor që zgjasin dhjetë minuta. Dhe

praktikisht secili merr detyrën për ndonjë konferencë për shtyp në të cilën kanë për të shkuar, dhe vrapojnë. Dhe këtu ishim, ata, kishte takime me redaktor për këtë edicion por edhe për revistat e ardhshme ku të gjithë përfshiheshin, fotografët, redaktorët e fotografisë, gazetarët dhe praktikantët. Dhe secili kishte, mirë, le të themi këto takime *brainstorming* zgjasnin për dy orë apo më shumë, thjesht duke dhënë ide, duke provuar të gjejmë perspektiva të reja – si mund të flasim për migrimin, si mund të flasim për seksualitetin ndërkohë që përqafojmë çështjet që dalin nga migrimi, për shembull.

Kështu që me të vërtetë ishte, gjithmonë ka qenë shumë sfiduese. Sepse në të njëjtën kohë ke përgjegjësi për krijimin e narrativave të reja, nxitjen e narrativave të reja dhe diskutimeve të reja publike për çështje që kishin ndikim të madh publik, dhe poashtu narrativa të cilat tashmë janë të mirëformuara, dhe me punën tonë, ne i sfidonim ato. Duhet ta bësh në një mënyrë që nuk të frikëson, por që gjithashtu është shpjeguese dhe të përfshinë edhe ty në këto diskutime.

Në fillim isha, isha praktikante duke punuar në edicionin “Seksi”. Pastaj, kjo praktikë ishte e supozuar të përfundonte pas, në fakt ishte e supozuar të përfundonte pas një muaji, por unë kisha mundësi të qëndroja më gjatë dhe me të vërtetë dëshiroja të qëndroja në mënyrë që t’i përfundoja storiet e mia. Dhe pas tre muajsh, m’u desh të largohesha, po mendoj, isha e supozuar të largohesha. Por dy gjëra ndodhën. E para në rend por jo për nga rëndësia, por njëra prej tyre, botuam edicionin “Seksi”, i cili erdhi i shoqëruar me shumë reagime nga pjesë të ndryshme të shoqërisë. Kur e lansuam revistën, kishte disa grupe që po protestonin në lansimin e saj, sepse ata argumentonin se publikimi i saj do të nxiste pëdorimin, dhe revista kishte... pjesë e përmbajtjes së saj kishte storie që flisnin për homoseksualitetin, masturbimin dhe çështje të tilla. Gjithashtu kishte storie që flisnin për gjëra si edukimi seksual në shkollat publike apo si prania e komunitetit ndërkombëtar ka pasur lidhje me rritjen e prostitucionit, prostitucionit ilegal dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Ka pasur shumë storie mbi çështje të ndryshme. Por me gjasë kjo që fliste për homoseksualitetin ishte shikuar më shumë nga media dhe poashtu nga grupet që ishin kundër këtij publikimi.

Dhe ditën që e kemi lansuar kam qenë aty, e kemi lansuar në “Boro Ramiz”, në Sallën e Kuqe, nuk jam shumë e sigurtë. Ky vend është shumë qendror dhe ne kishim përgatitur një festë të madhe, dhe gjithashtu përgjatë ditës kishim organizuar disa projeksione filmash, “Monoloku i Vaginave” dhe disa intervista të cilat i kishim realizuar me artistë, sociologë rreth perspektivave të tyre mbi seksualitetin e të tjera janë shfaqur gjatë gjithë ditës.

Kur po përfundonim përgatitjet për lansimin e diskutimit të cilin do ta kishim, ku kishim ftuar një artist, më falni, një aktivist nga Serbia dhe një nga Kosova. Ata po i lexonin njëri-tjetrit nga një letër të cilën e kishin shkruajtur, e kjo poashtu kishte shumë të bënte me, le të themi, bashkëpunimin ndër-kufitar dhe më shumë se aq, poashtu edhe mendime mbi vetë seksualitetin. Ishte shumë, përqafoje shumë çështje të ndryshme.

Vetëm disa, një orë apo kështu diçka më herët, një grup huliganësh erdhën në hapësirë duke shtkërruar gjithçka dhe duke bërë turr gjëra radikale si, “Allahu Akbar” e gjërë të tjera të ngjashme. Dhe pastaj u larguan e gjithçka u shkatërrua. Ishte me të vërtetë shokuese, ishte shok jo vetëm për mua por edhe për kolegët e mi nga këtu, njerëzit këtu, aktivistët të cilët nuk ishin të vetëdijshëm për këtë nivel të homofobisë apo për faktin se ky nivel i homofobisë mund të manifestohej në një mënyrë kaq agresive në një moment të caktuar.

Dhe ndodhi kjo gjë, ne vazhduam me ngjarjen tonë, diskutimi ndodhi në mes të manekinëve të thyer e gjëra të tilla. Dhe në mbrëmje, dyqind, treqind njerëz ishin mbledhur jashtë hapësirës për të protestuar kundër festës që kishim organizuar për në mbrëmje, ku kishim ftuar një DJ, e kishim

rezervuar gjithë hapësirën sepse prisnim rreth dymijë njerëz të vinin, ishte e supozuar të jetë shumë e madhe. Dhe ishte një përzierje e islamistëve radikalë dhe disa huliganëve nga ekipet e futbollit të cilët kishin shkëmbyer shumë komente në media sociale. Ata kishin shkruajtur në sesionet e komenteve të portaleve të lajmeve, të cilët nuk ishin të kujdesshëm për moderimin e tyre në atë kohë dhe gjithçka ishte një rrëmujë e vërtetë e komenteve me gjuhë urrejtje dhe gjithçka rezultoi që kjo ngjarje të ndodhte në atë mënyrë.

Na u desh ta anulojmë festën për arsye se nuk mund të siguronim hapësirën. Edhe pse njerëzit dëshironin të vinin dhe ne do të kishim dashur ta mbajmë. Siguria nuk u garantua edhe pse policia ishte aty, por me të vërtetë nuk ishte e sigurtë nëse sigurimi do të mund t'iu dilte në ndihmë të gjithëve. Dhe bazuar në këtë, u morr vendimi për ta anuluar. Ditën tjetër, natyrisht gjithçka doli në media sepse patëm edhe disa kamera aty, kishim media të cilët tashmë ishin duke bërë intervista për ngjarjen dhe gjithçka ishte në kamerë dhe u shndërrua në një diskutim të madh nëpër media gjithashtu. Por në të njëjtën kohë ishte mirë që krijoi shumë diskutim, dhe edhe pse nuk ishte gjithmonë mënyra më e mirë për të diskutuar çështje të tilla, megjithatë ndoshta kështu u diskutua më gjerë në një mënyrë më të dukshme. U qartësua, u qartësua edhe çështja e komunitetit LGBT por edhe niveli i homofobisë, ku mund të arrijë dhe veprimet që duhej ndër marrë u bënë më urgjente.

Pra, pas kësaj ngjarje, unë mendoja me veten se kjo gjë që po bëjmë, mund të duket sikur 178 faqe letër por megjithatë po ka një ndikim. Kështu që, me të vërtetë dua të vazhdoj të punoj, dhe në të njëjtën kohë takova dikë që tani është partneri im dhe doja të vazhdoja edhe atë. Kështu, për disa arsye, të gjitha u bashkuan dhe m'u ofrua një punë për të vazhduar të punoj në Kosova 2.0 si gazetare dhe projekte të tjera që lidheshin me zhvillimin strategjik të organizatës. Kështu që, vazhdoj të punoj ende.

Dhe pastaj kam punuar në të dyja, kam punuar si gazetare për organizatën, por poashtu edhe si menaxhere e programit. Kur kam punuar si gazetare, kam mbuluar kryesisht çështjet e artit, çështjet që lidhen me art. Kam, më pëlqen të bëj intervista (qeshë) dhe gjithashtu më pëlqejnë gjithë çështjet tjera shoqërore. Kështu, kisha mundësinë të bëj disa gjëra dhe të punoj si gazetare dhe në të njëjtën kohë kam zbuluar se mund të përktheja punën si gazetare në aspektin organizativ si koordinatorë e projektit dhe sot punoj si menaxhere e programit duke qenë në të njëjtën kohë prapa shumë veprimeve të tjera. Provojmë të organizojmë diskutime që çdo herë e më shumë po mbledhin dhe përfshijnë më shumë njerëz të cilët në një mënyrë po krijojnë dialog rreth çështjeve me perspektiva që mungojnë në debate publike në përgjithësi dhe në media apo...

Kështu që, kam provuar ta përkthej, ta zhvendos këtë funksion të gazetares edhe në anën e qytetarisë aktive, dhe tashmë i bëj të dyja. Tani nuk bëj shumë gazetari, sepse jam plotësisht e dedikuar në programin e organizatës dhe mendimin e aktiviteteve, avokimit dhe atë që mund të bëjmë për t'i shtyrë gjërat përpara paralelisht me prodhimin editorial që bëjmë.

Pjesa e Tretë

Mia Crocetti Marzotto: Çështjet në të cilat ke punuar, me të cilat ndihesh e afërt në mënyrë të veçantë? Apo që kanë...

Cristina Marí: Si një...

Mia Crocetti Marzotto: Që kanë shënuar përvojën tënde këtu?

Cristina Marí: Si gazetare apo në përgjithësi?

Mia Crocetti Marzotto: Epo, gjatë punës përgjatë këtyre viteve në Kosova 2.0. Në përgjithësi, si gazetare dhe si menaxhere e programit.

Cristina Marí: (Qeshë) Hmmm, natyrisht edicioni “Seksi” ka qenë ajo që ka definuar punën që unë doja të bëja. Jo pse ishte hera e parë që kisha ardhur këtu dhe hera e parë që kisha punuar me një ekip të tillë editorial, por gjithashtu për shkak të çështjeve me të cilat merresha. Gjithmonë kam qenë e interesuar në seksualitet, feminizëm dhe të gjitha çështjet që lidhen me gjininë dhe politikën, por gjithashtu “Migrimi” ka qenë një çështje që më ka interesuar për kohë të gjatë.

Dhe kur kam punuar në revistën “Migrimi”, kam shkruajtur një storie për një burrë spanjoll të martuar me një grua kosovare. Dhe kjo, unë isha e lidhur me këtë storie shumë për arsye se jam në një situatë të ngjashme ku partneri im nuk mund të vizitojë vendin tim për shkak të vizave. Dhe vizat nuk iu lëshohen as turistëve e madje as shkencëtarëve për vizita në Panairin Botëror të Shkencës atje. Nuk ka viza fare. Kështu që, ishte një çështje me të cilën isha shumë e lidhur. Dhe përmes revistës “Migrimi”, unë e kam treguar atë storie, e cila ishte shumë unike, jo e imja, ishte ndryshe (qeshë), dy njerëz.

Por gjithashtu, migrimi është çështje e cila është shumë e afërt për mua. Ndoshta për arsye se edhe unë jam zhvendosur dhe edhe unë jam migrante në një mënyrë, jo në një mënyrë, por e tillë jam. Por gjithashtu për arsye se mendoj se migrimi me të vërtetë po ndryshon shoqëritë tona dhe është çështje shumë aktuale. Kështu puna në atë revistë ishte në mënyrë të veçantë sfiduese. Si gazetare nuk kam shkruajtur vetëm disa storie në... Nuk kam shkruajtur vetëm storie si... nganjëherë si ekip editorial kemi punuar... shumë storie janë diskutuar përgjatë takimeve *brainstorming* saqë është tepër sfiduese nganjëherë, jo vetëm për shkak të asaj që je duke bërë, por gjithashtu edhe për shkak të asaj se çfarë duhet të ndërmerresh, sfida për të krijuar një revistë të tërë me një ekip njerëzish me perspektiva të ndryshme.

Kështu që, duhet shumë diskutim dhe secili nga këto takime është një proces mësimi në vete. Por pastaj fillova të punoj më shumë... ndoshta në mbulimin e artit. Disi fillova të mbuloj më shumë çështje të artit, kulturës. Ndoshta duke qenë se me të vërtetë më pëlqen të bëj intervista dhe disi u bë, në fakt edhe kishim nevojë për përmbajtjen që kishim atë kohë. Por gjithashtu ishte më e lehtë nganjëherë sepse kishte shumë artistë interesantë që vizitonin dhe ishte shumë interesant t'i intervistonim ata.

Por kurrë nuk kam pasur njohuri të vërtetë mbi artin. Ka njerëz shumë interesant (qeshë) kështu që besoj që kjo gjë ka... Më ka pëlqyer shumë që kam pasur rastin të intervistoj shumë njerëz të ndryshëm dhe interesant. Jam ndier në hapësirën time, e keni parasysh, kur bën intervista. Kam intervistuar muzicentë shumë interesant si Ian F. Svenionius i cili është një djalë Rock and Roll. Dhe poashu artistë si Alfredo Jaar, njerëz që kanë bërë histori në jetën e tyre. Kështu që, supozoj se gjithmonë jam e interesuar për njeriun prapa arritjes sesa për arritjen si të tillë. Edhe pse të dyja janë pabesueshëm interesante. Por kam pasur rastin të bëj disa intervista shumë interesante, të kem biseda shumë interesante me njerëz interesantë.

Kështu... pastaj i jam futurë më shumë fushës së koordinimit dhe menaxhimit të projekteve, unë, ka ndodhur shumë natyrisht sepse isha me të vërtetë insistuese për të bërë gjithmonë e më shumë

gjëra. Si mund të bëjmë më shumë e më shumë, të mbledhim më shumë njerëz në mënyrë më kreative. Dhe disa gjëra për të cilat jam shumë e lumtur janë, ndoshta është fakti që kemi arritur të rritemi në nivele të ndryshme dhe kjo... për shembull tani jemi duke organizuar bisedat e shkurtëra në të cilat po përpiqemi të sjellim sa më shumë njerëz që janë të interesuar në një çështje, por poashtu provojmë të sjellim politikanë vendor të cilët punojnë në atë fushë në mënyrë që t'i bashkojmë njerëzit, por jo në një sallë konferencash në ndonjë hotel ku nuk do të shkojë askush, por në hapësira të hapura apo qendrore ku të gjithë mund të vijnë dhe të ndihen të angazhuar.

Po eliminojmë strukturën e panelit kundër audencës, ku ka vetëm pesë njerëz që i flasin një audience. Dhe pastaj në fund, pas një ore bisede ata bëjnë pyetje. Jo vetëm pyetje... Çfarë, pse, pse... nuk vjen këtu për t'u bërë pyetje ekspertëve por për të biseduar. Ke ide për zgjidhje për një çështje të caktuar, ky është një forum, je i mirëseardhur. Jo vetëm për të zgjidhur probleme por edhe për të ndarë mendime apo diçka që me shpresë do na sjellë përpara një... dhe kemi bërë tema të ndryshme, nga hapësirat publike dhe ripërdorimi i tyre tek migrimi dhe gjithë temat tjera. Një listë e gjatë tani (qeshë) sepse kemi filluar të bëjmë diçka të tillë që disa vite tashmë dhe ka funksionuar mirë.

Gjithashtu kemi bërë disa kampanja. E fundit ka qenë njëra për të cilën jemi shumë krenarë, e cila është quajtur, "Po du me ditë". Një nga projektet avokuese në të cilat kam pasur dëshirë të punoj ka qenë kampanja të cilën e kemi lansuar vitin e kaluar e cila quhej "Po du me ditë". Dhe përmes videove dhe formave të tjera *offline*, synonte të inkurajonte qytetarët të shfrytëzonin mediat sociale dhe thurjen, "Po du me ditë", për të bërë pyetje dhe kërkuar informacion nga institucionet publike, përfaqësues të insitucioneve publike, politikanët në përgjithësi. Dhe mbase nuk kanë marrë përgjigje nga ata {bën me shenjë me gisht} ashtu siç kemi shpresuar. Nuk kemi pritur të marrim shumë përgjigje.

Por mendoj se me të vërtetë ka pasur një pjesë të ndikimit në ngritjen e vetëdijes rreth nevojës së qytetarëve, si qytetarë ndihemi më të përfshirë në kërkesën për informacion dhe ushtrimin e të drejtës për informacion. Dhe ndoshta në një mënyrë, për të ndarë mendimin se si qytetarë, edhe ne kemi përgjegjësi, nëse duam ta marrim, jo që duhet me patjetër. Sepse natyrisht, të gjithë përballen me shumë çështje të ndryshme në jetërat e tyre. Por mund të dalë diçka e mirë, nëse bashkohemi për t'iu bërë presion institucioneve të cilat jo gjithmonë janë duke na dëgjuar.

Kështu që, ky ishte një projekt kreativ. Ishte gjithashtu kampanjë avokimi e cila poashtu ka ndikuar në kuptimin tonë për atë që njerëzit kanë nevojë të dijnë. Dhe kjo ndodhi në një kohë kur kishte shumë diskutim rreth dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë. Këto lloj narrativash që janë shumë të përhapura në media dhe gjithmonë shumë të pranishme në diskutime publike në fakt nuk ishin shumë të pranishme në pyetjet apo kërkesat e qytetarëve. Ata ishin të interesuar të mësojnë se çfarë do të ndodhë me shërbimet publike, si do të zhvillohen, si do të zhvillohet sistemi shëndetësor, si do të zhvillohej sistemi i mbledhjes së mbeturinave, si mbrohen të drejtat e minoriteteve, si mbrohen të drejtat e grave, por në mënyrë të veçantë ishin të interesuar për dhunën në familje, si do të luftohej dhuna në familje.

Kështu që, ishte përndritëse për ne të shohim atë përgjigje, dhe kemi provuar ta përdorim edhe në punën tonë editoriale, të implementojmë dijen që e kemi marrë dhe pyetjet e qytetarëve në punën që ne bëjmë çdo ditë. Pra, më pëlqen të qenit gazetarë, dhe tani për tani punoj për të menduar aktivitete dhe veprime të cilat mund të na ndihmojnë të ecim përpara me biseda të reja. Dhe ndoshta duke qenë se kam qenë gazetarë më parë, e kuptoj, ose dua të mendoj se e kuptoj si mundemi ne si organizatë mediale të krijojmë hapësira të ndryshme të diskutimit ose të nxisim diskutim mbi çështje të

ndryshme në mënyra të ndryshme, ndoshta mënyra më kreative, më angazhuese, duke shfrytëzuar të njëjtat vlera të gazetarisë.

Ndoshta ky është një ndryshim i madh për qasjen fillestare klasike rreth gazetarisë dhe medias, me të cilën kam filluar. Por mendoj se në fund e kanë plotësuar njëra-tjetrën. Dhe shpresoj të vazhdojë kështu (buzëqeshë).

Mia Crocetti Marzotto: Si është të qenit aktiviste në një ambient që nuk është vendi prej nga vjen?

Cristina Marí: Epo, po. Nuk jam e sigurtë nëse identifikohem si aktiviste. Identifikohem, por në njëfarë mënyre ndihem sikur si gazetare je pjesërisht aktiviste sepse bën shërbim publik, dhe kështu e kuptoj. Në të njëjtën kohë, këtu jam e huaj. Këtu jam një *expat* për shumicën e njerëzve që e shohin emrin tim të shkruajtur diku dhe nuk e dijnë kush jam. Dhe kjo çështje është mjaft sfiduese për mua, dhe e mendoj shpesh. Sepse edhe pse jetoj këtu tash e pesë vjet, kam mësuar gjuhën mjaftueshëm sa për të bërë biseda. Së fundmi kam qenë në televizion, isha shumë krenare që arrita të bëj një intervistë të plotë në shqip. Dhe kam mësuar, e gjithë shoqëria ime janë prej këtu, shumica prej tyre. Partneri im është prej këtu, kam kaluar nëpër shumë përvoja me të dhe familjen e tij si pjesë e jetës këtu. Dhe jam këtu, jetoj këtu, nuk e shoh veten si *expat* apo si e huaj.

Gjithmonë e kuptoj fjalën *expat* si të ngarkuar me status dhe privilegje në një mënyrë. Sepse disi kur je *expat*, je dikush që ka ardhur nga jashtë dhe për ndonjë arsye, nuk është integruar tamam. E kuptoj gjithashtu, sidomos këtu në Kosovë, ku ka një komunitet kaq të madh ndërkombëtar të lidhur ngusht me krijimin e institucioneve, poashtu të lidhur me punën e këtyre institucioneve. Shpesh më pyesin, “A punon në EULEX?” Ose, “A punon në KFOR?” Është ose njëra ose tjetra. Kurrë nuk mendojnë se mund të punoj në një organizatë të shoqërisë civile ose... Po mendoj, megjithatë shoqëria civile mund të jetë opsioni i tretë ose i katërt që njerëzit e mendojnë për një të huaj. Por shpesh mendojnë se punon për institucione si EULEX-i, KFOR-i, BE-ja apo ndonjë nga këto të mëdhatë.

Dhe kjo vjen me ideologji sepse këto institucione kanë politika ose kanë implementuar punë që ka pasur disa pasoja ose nuk ka përmbushur pritshmëritë e shoqërisë së këtushme. Kështu që po kthehem te ajo se si ndihem këtu, duke qenë një e huaj, dhe si ndihem këtu qoftë si aktiviste apo gazetare. Gjithmonë ndihem sikur duhet të jem e kujdesshme sepse nuk përceptohem si njeri nga këtu prej shumicës që nuk më njeh. Njerëzit që më njohin më trajtojnë si një më shumë... si dikush që e kupton për çfarë po flasim, jo vetëm në aspektin gjuhësor por edhe kulturalisht dhe mënyrën si gjërat funksionojnë këtu.

Dhe nëse do të isha në shtëpi, besoj se do të isha shumë më aktive. Mendoj se do të mund të kisha një lloj nisme të pavarur, jo vetëm përmes organizatës sime por edhe personalisht... nuk e di... ekziston një hapësirë këtu në lagjen time e cila mendoj se do të ishte ideale për të organizuar mbledhje të lagjes nganjëherë për të folur për çështjet që na shqetësojnë. Por gjithmonë mendoj nëse një e huaj troket në derë duke iu thënë, “Ejani të flasim për problemet që kemi...” Gjithmonë do të jetë sikur tregues mëshire, për disa në mos për shumicën prej tyre. Nuk dua të krijoj qasje të tillë, dhe nuk dua të nxis konfrontime... Kështu që, kam psikanalizuar të gjitha perspektivat e mundshme për të parë se si do të pritej diçka e tillë. Dhe gjithmonë mendoj, nëse njerëzit më njohin do ta kuptojnë atë që po mundohem të bëj dhe nuk do ta shohin, ose të paktën shpresoj se nuk do ta shohin si tregues mëshire. Apo si një e huaj që mundohet t’iu tregojë si funksionojnë gjërat, “Duke qenë se kjo është e huaj, në shtetin e saj gjërat janë ndryshe, gjërat funksionojnë dhe kjo mundet...” Jo, në fakt as në vendin tim gjërat nuk funksionojnë aq mirë (qeshë).

Gjithmonë ndihem sikur duhet të jem shumë e kujdesshme dhe të kuptoj e t'i qasem mirë secilit person, natyrisht. Dhe të mundohem të lidhem me ta në një mënyrë horizontale. Nuk po mundohem... nuk po mundohem t'i mësoj askujt asgjë. Po mundohem t'ia mësoj vetes atë që është më e mira, mënyrën më të mirë për t'i bërë gjërat, por nëse e bëj këtë gjë vetëm, nuk do të mund të bëj asnjë ndryshim. Por duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin, ndoshta ti më ndihmon mua, unë të ndihmoj ty dhe ecim përpara.

Ende, edhe kur më kërkua të bëj këtë intervistë, mendova dy herë rreth çështjes, "Oh, por unë jam një e huaj. Për çfarë do të më pyesin? A do të jetë për..." Nuk e di, nuk isha e sigurtë. Natyrisht, e kam pranuar me kënaqësi, në mënyrë që të mundem të shpjegoj edhe këto perspektiva në një mënyrë më të gjerë. Por mendoj, dhe e kuptoj këtë ndjenjë, sepse është aty. Ndjenja se të huajtë vijnë për të na mësuar si të jetojmë. Është aty dhe tërësisht e justifikueshme, sepse kështu ka ndodhur. Është aty në institucione, është institucionalizuar, kjo qasje, kjo qasje mëshire. Nganjëherë për arsye të mira, por në të shumtën e rasteve në mënyra të gabuara por çfarë dua të them është se e kuptoj këtë frikë apo refuzim, skepticizëm ndaj një të huaji që ndërmer nisma. Por për atë arsye unë po mundohem që në mënyrë shumë të kujdesshme të jem pjesë e gjithçkaje që bëj.

Që nga fillimi e kam ditur që duhet të mësoja gjuhën nëse doja të punoja këtu, nëse doja të jetoja këtu. Kam filluar shumë ngadalë ndoshta që nga dita e parë kur e kam kuptuar se do të rrija këtu për më shumë se tre muaj. Dhe pastaj, ngadalë me miq dhe të gjithë të tjerët kam mësuar për çështjet me të cilat ata përballen. Dhe unë jam përballur me çështje të ndryshme duke jetuar këtu dhe duke qenë pjesë e jetës së përditshme.

Por përsëri, të qenit e huaj, nuk më pëlqen ta quaj veten të huaj, disi fjala nuk më duket korrekte (qeshë). Jam një e huaj, vij nga një vend tjetër por jetoj këtu, jam banore e Prishtinës. Marrë pjesë në jetë, shkoj në ngjarje dhe nëse do të kisha mundësi, edhe do të votoja (qeshë). Por kjo gjë nuk lejohet ende për të huaj kështuqë shpresoj se ndonjë ditë, ndoshta (buzëqeshë). Dhe ndjej sikur kam aftësi, edhe gjuhësore, të angazhohem the të tregoj se unë... nuk është gjuha ajo që të angazhon, por e lehtëson mënyrën për të marrë pjesë, për shembull, intervista në televizion, ose së fundmi kam moderuar një debat. Kështuqë ky lloj ekspozimi të ndihmon ta ndjesh veten si pjesë e vendit ku je, të nidhesh më e përgjegjshme për të... të dhuron një mjet për të filluar të qenit më aktive dhe për ta shfrytëzuar atë në një mënyrë tjetër. Dhe me shpresë do të eci përpara me të (gjuhën) ndërkohë.

Mia Crocetti Marzotto: Pra, si e gërshetoni këtë idenë e të qenit e huaj që vjen këtu dhe imponon mënyrën e saj të të bërit të gjërave, por gjithashtu edhe mikpritjen e ngrohtë që e përmende që ke hasur kur ke ardhur për herë të parë? Si mendon se mund të shkojnë këto dorë-pas-doe? Ose, a të ka bërë përvoja jote duke qenë e mirëseardhur në Kosovë të kuptosh më mirë këtë përceptim dhe arsyet pse një i huaj mund të shihet si imponues?

Cristina Marí: A mund të mendoj? (qeshë)

Mia Crocetti Marzotto: Po.

Cristina Marí: Mund të them se kulturalisht, shoqëria kosovare, dhe këtu mund të flas më shumë për shoqërinë shqiptare, është natyrshëm mikpritëse dhe mikpritja është shumë e pranishme, shumë e ngulitur në kulturë dhe daton shekuj më parë, dhe ky virtyt ka mbetur dhe ende është shumë i dukshëm në njerëz. Por mendoj se eventualisht mund të zhduket nëse abuzohet me këtë besim dhe

këtë mirësi, në një mënyrë. Kështuqë ndihem sikur... e kemi një shprehje në spanjisht, përsëri një shprehje spanjolle, e cila thotë se kur ia jep dikujt dorën, të merr gjithë krahun. Mendoj se kjo është diçka që mund të përfaqësojë idenë që kam, kur të ofrohet mirësi, nuk do të thotë që duhet të abuzosh me të. Dhe nuk mund ta marrësh besimin e dikujt e pastaj të abuzosh me gjithë potencialin e tyre dhe t'iu tregosh çfarë të bëjnë me jetën e tyre, apo të diktosh mënyrën si ata sillen, apo si duhet të sillen me ty ose...

Mendoj se të gjitha raportet duhet të jenë horizontale dhe në atë mënyrë, të gjithë njerëzit e përfshirë, ndihen të mirëseardhur në atë raport, edhe i huaji edhe “vendasi” {bën thonjëzat me duar}. Por mendoj se për t'u pajtuar me idenë e të qenit e huaj dhe pastaj këtë mirësi dhe të mosqenit...Supozoj se çfarë po them është, mos abuzoni me mirësin dhe kjo mirësi vjen për arsye se ky person është autokton dhe e di shumë mirë çfarë do. Ose të paktën kanë integritet dhe e dijnë se ajo mirësi është pjesë e një tradite dhe integriteti që ata kanë. Kështuqë mos abuzoni me të, mos u sillni në atë mënyrë që ata të mendojnë se jeni duke nënvlerësuar inteligjencën e tyre ose...po iu tregoni si duhet bërë gjërat. Sepse nuk e di nëse çfarë po bëj ose çfarë kam bërë në jetë është mënyra më e mirë për t'i bërë gjërat.

Dhe natyrisht që dikush që vjen nga jashtë ka përvoja të ndryshme por pastaj vjen në një vend që nuk funksionon në të njëjtën mënyrë si vendi yt, ose ndoshta edhe funksionon njësoj, por duhet ta njohësh. Fillimisht mendoj se duhet të vish si tabula-rasa dhe të fillosh nga zero, ku ti nuk njeh askënd dhe askush nuk të njeh ty, në këtë mënyrë mund të mësojmë nga njëri-tjetri, çfarë na mungon ose si mund të kontribuoj unë në atë që ti je duke bërë, ose si mund të kontribuosh ti në atë që unë jam duke bërë. Dhe po flas për raporte njerëzore, nuk po flas për raporte shtetërore ose gjëra të tilla.

Por mendoj se situata politike në Kosovë dhe mënyra si komuniteti ndërkombëtar i ka kontribuar shtetndërtimit të Kosovës dhe shoqërisë këtu ndikon në mënyrën si të shohin njerëzit ty që vjen nga jashtë. Unë jam gjithmonë, jam nga Spanja, një shtet që nuk e njeh Kosovën. Dhe gjithmonë më pyesin, “Si, kur do të na njihni?” Por gjithmonë me shumë mirësi, e dini. Kurrë nuk e thonë me të keq, kurrë nuk thuhet si... sepse njerëzit të trajtojnë si njeri, dhe edhe unë mundohem të bëj të njëjtën gjë. Nuk e di, nuk e di nëse po e shpjegoj qartë, por... (qeshë)

Mia Crocetti Marzotto: Po, definitivisht. A je ende në kontakt me njerëzit që të kanë mirëpritur në Pejë?

Cristina Marí: Jo, nuk jam. Po mendoj, i kam të gjithë në Facebook. Disi jam ndjerë sikur, e kam një qasje për disa takime në jetë për të cilat mendoj se nuk janë të destinuara të përsëriten, as të zgjasin e as të zgjerohen. Janë të mira, janë të shkurtëra por të bukura. Dhe disi qëllimshëm kurrë nuk jam kthyer në atë fshat. Jam ndjerë sikur kam marrë mjaftueshëm, dhe nëse do të kthehesha do të nënkuptonte që do të vazhdoja të merrja, në një mënyrë (qeshë). Dhe nuk e di, do të doja të kthehesha, por disi kemi kontaktuar, kemi shkruajtur me njëri-tjetrin, “Çfarë po bën? Si po shkon jeta?” Disa janë larguar nga qyteti tashmë. Por disi në një mënyrë kam qenë në kontakt.

Do të doja të kthehem, ndoshta tani që e flas edhe gjuhën dhe mund të komunikoj em të gjithë. Do të ishte një përvojë shumë më e mirë edhe për ata për të parë që nuk kam qenë thjesht duke kaluar, por kam vendosur të mësoj më shumë. Në të kaluarën ishte edhe çështja e gjuhës, sepse unë nuk kam folur aspak shqip në vitin e parë. Kështuqë ka qenë e vështirë të komunikoj, por...Por gjithashtu kthehem tek mendimi se disa gjëra nuk janë të destinuara të përsëriten, ndoshta. Është disi, natyrisht,

do të, do të ishte shumë mirë të kthehem e t'i vizitoj dhe nuk do të thotë që nuk do të bëj diçka të tillë, por disi kam pasur këto mendime, e dini, kur krijon një pikturë që është e përsosur dhe vazhdon ta prekësh megjithatë dhe në fund mund ta shkatërrosh (qeshë).

Somehoë I had a really beautiful experience and I wanted to conserve it exactly as it happened. But sure I will eventually, noë that I have the ability to speak and communicate it will be great to, to go back to it and learn more about it.

Disi kam pasur një përvojë tepër të bukur dhe kam dashur ta konservoj saktësisht ashtu siç ka ndodhur. Por sigurisht, tani që kam aftësinë të flas dhe komunikoj, eventualisht do të kthehem dhe të mësoj më shumë rreth tyre.

Mia Crocetti Marzotto: A kanë ardhur prindërit ose motra për vizitë ndonjëherë këtu?

Cristina Marí: Jo, nuk kanë ardhur. Familja ime nuk ka ardhur asnjëherë, nuk udhëtojnë shumë, po mendoj, motra ime udhëton më shumë por tani ajo ka një vajzë kështuqë... prindërit e mi, babai im nuk ka dalë nga ishulli me vite dhe unë e di se nëna ime dëshiron të vizitojë eventualisht. Shpresoj se po, (qeshë), por jo, ende nuk më kanë vizituar. Për asnjë arsye të veçantë, por më shumë për shkak të logjistikës. Për të shkuar në Spanjë zakonisht nevojiten tre aeroplanë për arsye se nuk ka fluturime direkt në mes Kosovës dhe Spanjës. Dhe në anën tjetër unë vij nga një ishull, kështuqë shpesh duhet një fluturim më tepër. Kështuqë gjithmonë ka qenë disi e vështirë, por shpresoj se në të ardhmen do të takohemi në ndonjë pikë të mesme, ose të paktën këtu.

Mia Crocetti Marzotto: Sa shpesh shkon në Ibiza?

Cristina Marí: Zakonisht shkoj dy herë, deri tani kam shkuar dy herë. Zakonisht udhëtoj në korrik dhe në dhjetor në kohën e Krishtlindjes. Por këtë herë kam shkuar në prill, sepse mundohem të kaloj... gjithmonë skoj në shtëpi për pushime kështuqë kurrë nuk kam mundësi të udhëtoj nëpër rajon. Nuk kam udhëtuar shumë që nga...Po mendoj, kam udhëtuar ngapank në rajon por kurrë gjatë kohës së lirë për të shijuar dhe provuar gjëra të reja. Kështuqë këtë vit dua të shkoj në jug të Shqipërisë dhe me shpresë t'i rrokem rrugës dhe të shoh disa vende më të fshehura përtej atyre që janë kryesore.

Për arsye se gjithmonë shkoj në shtëpi, në korrik dhe në dhjetor, kjo praktikisht më merr gjithë kohën e pushimeve dhe nuk mund të shkoj (qeshë). Kam nevojë të shkoj në shtëpi, të kem ndjenjën e shtëpisë dhe të pastroj trurin pak, të kaloj kohë në shtëpi. Po...

Mia Crocetti Marzotto: Dhe si ua përshkruan jetën këtu njerëzve në shtëpi ose miqve tu që jetojnë diku tjetër?

Cristina Marí: (qeshë) Hmm, mendoj se është shumë e vështirë të shpjegohet sepse nuk kanë parë asgjë dhe Prishtina është vend i vogël. Nuk është kryeqytet i madh evropian që, nuk e di, disi ka shumë për të ofruar, shumë vende për të shkuar e për të vizituar. E dini, nganjëherë kam përshtypjen, jam mësuar...Tani kam ujë 24 orë, por më parë nuk kishim, kishim reduktime të ujit gjatë natës pas orës 10 dhe unë u mësova me këtë gjë, nuk ishte problem fare për mua. Por nëse e përmend ndonjëherë, thjesht për arsye se ka ndodhur, nuk e di, ndoshta duke folur në telefon me familjen {shikon orën e dorës}, "Më duhet të shkoj sepse dua të bëj ush, sepse në 10 nuk do të kem ujë". E bëja krejt paqëllimshëm (qeshë), por pas një kohe nëna ime u bë, më duket sikur ajo mendon se asgjë nuk funksionon këtu (qeshë).

Por nuk e di, natyrisht, mendoj se ata ia kanë idenë që ky është një vend i vështirë për të jetuar. Ndoshta sepse kur flet me miq, ke tendenca të shpjegosh më shumë sfidat me të cilat përballësh apo vështirësitë të cilat ekzistojnë. Dhe ndoshta nuk flet shumë rreth kohës së mirë që kalon këtu, apo...Ndoshta ata kanë ide të vrazhdë për Kosovën por në të njëjtën kohë iu kam treguar shumë për aspektin e mikpritjes dhe si, nuk e di...Sa të hapur dhe mikpritës janë njerëzit, poashtu për traditat...Sepse shpesh janë kuriozë, “Si janë traditat?” ose “A e festoni Krishtlindjen?” “Jo, por është Bajrami dhe kjo ndodhë...”

Dhe kur shpjegon gjithë këto dallime, janë kuriozë. Por eventualisht bisedat bëhen për jetën dhe varen nga ajo si jeta jote është, pastaj ata kanë idenë e tyre rreth asaj që unë bëj këtu. Mendoj se disi ata kanë një ide, ose miqtë gazetarë gjithashtu të shohin, “Uau, je në Kosovë. Je duke qenë gazetarë...” Mendoj se kanë një ide më të mirë, më të madhe për atë që bëj, sesa un, e dini, “Ajo është në Kosovë, me siguri është duke bërë diçka madhështore”. E dini, thjesht për arsye se je larg në një vend që ka të kaluar konfliktuoze, mund të jesh duke bërë ndonjë raportim për luftën ose diçka e tillë, luhet shumë me këto paragjykitime të cilat mundohem ti shkatërroj sa më shumë që mundem.

Dhe natyrisht të gjithë janë të nervozuar me faktin që Spanja nuk iu jep viza kosovarëve. Dhe kam folur shumë për këtë çështje me ta dhe janë shuëm të vetëdijshëm. Nuk e kuptojnë, disi vjen me një shok, shpesh nuk dijnë asgjë për këtë fakt. Askush në Spanjë nuk e di se Spanja nuk iu jep viza kosovarëve dhe askush nuk e kupton çfarë do të thotë kjo, çfarë është viza. Për arsye se ne jemi bërë qytetarët e privilegjuar të Bashkimit Evropian të cilët udhëtojnë pa viza, vetëm me pasaportë. Dhe vetëm ideja për të shkuar në ambasadë me dokumentacionin e gjithë jetës për të kërkuar leje udhëtimi është e pakapshme për ta. Kështuqë është diçka për të cilën flas shumë. Ndoshta kjo i kontribuon imazhit se Kosova nuk funksionon (qeshë). Ka problemet e veta, natyrisht sikur secila shoqëri, por shpresoj se do t'i tejkalojmë këto sfida.

Mia Crocetti Marzotto: Falemnderit shumë, mendoj se kam bërë të gjitha pyetjet që kam dashur...

Cristina Marí: Në rregull...

Mia Crocetti Marzotto: Nuk e di nëse dëshiron të shtosh diçka tjetër ose thjesht të riformulosh ndonjë nga mendimet tua, ndihë e lirë...

Cristina Marí: Jo, edhe unë mendoj se kam përfshirë gjithçka. (qeshë)

Mia Crocetti Marzotto: Po, falemnderit shumë!

Cristina Marí: Më falni nëse jam zgjeruar shumë në ndonjërin nga çështjet...

Mia Crocetti Marzotto: Jo, jo, ishte e këndshme të dëgjosh historinë tënde jetësore, është interesante.

Cristina Marí: Po, në fakt më ke bërë të flas për gjithçka...(qeshë)

Mia Crocetti Marzotto: Kjo me siguri do të thotë që kam bërë punë të mirë...

Cristina Marí: Po, po. Shpresoj që keni kuptuar gjithçka...